

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME ZYMER NEZIRIN

Prishtinë | Data: 15 prill, 2016

Kohëzgjatja: 138 minuta

Të pranishëm:

- Zymer Neziri (I intervistuari)
- Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
- Jeta Rexha (Intervistuesja)
- Noar Sahiti (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - e intervistuar shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

[Intervistuesja kërkon nga folësi të prezantohet dhe të flas për rrethin familjar në të cilin është rritur. Pyetja është prerë nga video intervista.]

Zymer Neziri: Po, quhem Zymer Neziri, por në shumicën e rasteve nënshkruhem si Zymer Ujkan Neziri. Domethanë, meqenëse mbiemrin Neziri e kemi ni mbiemër rasti kështu, po mendoj të administratës. Meqenëse, Neziri ishte katragjyshi im. Në kohën e gjyshit pastaj n’administratë atje e kanë regjistruar si Fazli Neziri dhe ne të tjerët në librat e të lindurve ashtu jemi. I takojmë barkut, si i themi, Nilaj, pra të vëllazërisë së madhe të Lajçit, domethanë të fisit Kelmend. Dhe këto ndarje natyrisht janë të pranishme ende në zonat e thella malore, pra në malet tona, por edhe në zonat kodrinore-malore, pjesën e rrafshit ma pak, në qytete edhe shumë më pak.

Familja ime n’kohën kur kam lindur unë ka jetuar në tri vende, në Shtupeq, pra në Rugovë, ka jetuar në Pejë në lagjen Kapeshnicë dhe ka jetuar në Zahaq, një katun shtatë-tetë kilometra afër Pejës. Ka jetuar në një bashkësi familjare pra, një bashkësi e shtatë familjeve në një familje. Pra babai im ka qenë vetë i shtati vlla në një bashkësi familjare. Në Pejë kanë jetuar zejtarët, në Zahaq apo sipas përpjekjes së re që e bamë pas luftës që emrat e shtetësinë sllave t’i mbulojmë me shtetësi të tjera, pra shqip pra ku kanë jetuar blegtorët, këta bujqit pra, ndërsa blegtorët në Shtupeq. Familja ka funksionuar taman si një shtet i vogël të themi, sepse secili kishte detyrimin e vet, punën e vet dhe secili e bante punën ashtu si duhet dhe kësisoji funksiononte familja, tamon si një bashkësi, bashkësi e vogël shtetnore. Baheshim bashkë vetëm në festa familjare pra, apo festa të tjera, në rastet e gazmendëve, raste të dasmave apo raste të vdekjeve, sepse shumë rrallë i shihshe të gjithë në një vend pra, meqenëse, meqenëse pra ishin shumë.

Në kohën kur u nda buka pra, domethanë në fillim të viteve ‘70 ne veç ishim shtatëdhjetë në bashkësi. Kjo bashkësi familjare e shpërndarë, domethanë në shtatë njësi në fillim të viteve ‘70. Dikur poashtu ishte e madhe në fillim të atij shekulli, saktësisht në vitin 1908 pra kur ishte prapë bashkësi shumë e madhe dhe u nda pra, u nda buka. Edhe një herë tjetër duhet të jetë diku rret vitit 1860 ku ishte prapë bashkësi e madhe familjare dhe prapë ndahet buka. Domethanë, babai im kishte kaluar në këto dy procese, unë përjetova procesin e tretë, pra gjatë fillimit të viteve ‘70, pra do të thotë për rreth një

shekulli e gjysë veç tri herë është ndarë buka në bashkësinë familjare tonën pra. Këtij rremi, domethanë Nilnikajve, ashtu quhemi pra Nilnikaj sipas vëllaut të pestë të... apo djalit të pestë të Nikë Dedës. Pra Nikë Dedë në këtë rast në aspektin etnografik ka statusin e vllazërisë, kurse Lajçi e ka statusin e vllazërisë së madhe ose statusin e nën-fisit pra.

Në bashkësinë familjare tonën natyrisht ka pasë edhe gëzime, ka pasur edhe më shumë se gëzime, ka pasur pra hidhërimë, pra ka pasur dëshprime. Ka pasur dëshprime të shkallës së lartë, pra në jetën në kushtet e robërisë pra kushtet e pushtimeve e luftimeve të gjendjes, domethanë në kohën pra, në kohën kur ishte edhe skamja e madhe dhe gjitha këto që i ka përjetuar jo vetëm krahina e Rugovës, Peja me rrethinë, por edhe shqipëtarët në përgjithësi, sidomos pjesa e zonës së veriut në kufi me Malin e Zi, por edhe me Serbinë. Pra janë natyrisht një pjesë e asaj që quhet traditë gojore dhe që fatkeqësisht nuk është shënuar dhe do të duhej të shënohet sepse nevojat janë të domosdoshme për t'rindërtuar një histori tonën të cilën nuk e kemi sepse vetëm hjekat e një familje, vuajtjet e një familje, pra një libër është pak të shënohen. Dhe të gjitha familjet shqipëtare pothuajse kanë kaluar nëpër t'njejtin fat, nëpër t'njejtat procese të historisë pra të dhembjes së madhe.

Familja ime {kollitet}... në vitet '40, në Luftën e Dytë Botërore, kur unë nuk isha i lindur ende, ka kaluar nëpër procesin e luftës dhe në mbrojtjen e kufirit me Malin e Zi, në Qafën e Çakorrit, në Mokna, në Smilevicë, në Hajlë deri në Kullë. Pra një kufi që e kufizon vetëm krahinën e Rugovës, por jo edhe rajonet e tjera shqipëtare që sot janë nën Malin e Zi. Fatkeqësisht Qeveria, Komisioni i Demarkacionit thonë sot, "Jo nuk është kufini në Qafë të Çakorrit, po osht' ma poshtë". Nuk është kufini në Kullë, po vazhdon deri në, deri në gjysmën e bjeshkëve të Shtupeqit. Këtë kufi e kanë mbrojtur Rugovësit, 600 burra. Ndër ta kam pasur aty edhe nga familja ime ose dy ose tre, ndër ta ka qenë edhe babai im, dhe kjo është ajo pjesa, pjesa që në histori prapë nuk është shënuar fatkeqësisht. Dhe është një histori natyrisht edhe e krenarisë sepse ai kufi është mbrojtur nga prilli 1941, pra pas rënies së Jugosllavisë dhe deri në dhjetor të 1944, pra pasi që hinë brigadat pra në këtë Grykën e Deçanit pra, dhe kalojnë. Një rrem i saj kalon në drejtim të Gjakovës dhe tjetri rrem në drejtim të Pejës, po pastaj natyrisht hyjnë edhe në, hyjnë në Rugovë.

Pjesa pasuese natyrisht është pjesë poashtu shumë e rëndë e burgosjeve, e vrasjeve në burgje. Dhe krahina e Rugovës bashkë me Pejën me rrethinë kalojnë prapë ditë shumë të vështira, por këso kohe megjithatë organizohet komiteti, komiteti pra apo mund të themi nën-komitet ashtu kishte statusin, i NDSH-së në Rugovë apo i Nacional-Demokrates. Dhe ai nën-komitet natyrisht në fazën e parë tubon 43 burra në krye me Sylë Mehmetin ma vonë i burgosur politik dhe një prej njerëzve ma të qëndrueshëm në burgjet jugosllave nga Nishi edhe deri në Goli Otoku.

Erëmirë Krasniqi: Në cilën moshë keni jetu në bashkësi familjare?

Zymer Neziri: E përsërisni pyetjen?

Erëmirë Krasniqi: Deri në cilën moshë keni jetu në bashkësi familjare?

Zymer Neziri: E unë thashë deri në fillim të viteve '70, domethanë unë atëherë isha, isha mbi 23-24 vjeç kështu. Domethanë n'moshë madhore ata ishin shtatë, babai me vllazër, ne ishim 17 domethanë brezi i djemve të axhës dhe vajzat bashkë me to ishim diku 24, domethanë që ishim brezi i dytë i familjes. Pastaj vinin brezi i grave, i nënës me gratë e axhallarve, brezi i nuseve që ishin ardhë domethanë nuse në familjen tonë dhe kësisoj pastaj i fëmive domethanë brezi i tretë.

Erëmirë Krasniqi: A kishim mujt me u kthy pak te edukimi i jujë, domethon ku ka ndodhë ajo, a ke qenë në Pejë apo në Zahaq?

Zymer Neziri: Po, fillimisht në Zahaq isha katër vjet e para, meqenëse babai im ishte përgjegjës i tokës kishim aty mbi njëzet e sa hektarë tokë dhe nëna natyrisht jetonte aty. Unë aty fillova edukimin fillor në Zahaq në katër klasët e para me mësuesin Bajram Shala, po. Dhe ka qenë një mësues shumë i mirë, natyrisht i atyre mësueve që nuk kishin kualifikim të mjaftushëm por kishin vullnet shumë të madh, zell shumë të madh dhe bënin përpjekje shumë të mëdha për t'ngritur një brez pas Luftës së Dytë Botërore. Dhe unë jam shumë i lumtur pra që kam qenë nxënës i Bajram Shalës mësuesit pra në Siparant dhe në Zahaq dhe pas Siparantit kalova në Pejë në pjesë e dytë të fillores, në shkollën e mes... në shkollën fillore "Ramiz Sadiku", tash në fund të qytetit po me kujdestar klase arsimtarin Lutfi Kotorri, paralelja V/3. Kam pasur fatin dhe nderin natyrisht historik t'kem shokë që ma vonë kanë krijuar emër në histori pra, si Isuf Gërvalla, pastaj Skender Blaka edhe disa të tjerë domethanë kemi qenë nxënës të klasës V/3. Aty kam mbaruar vitin e pestë, vitin e gjashtë dhe të shtatin e pastaj kam kaluar drejtpërdrejtë në gjimnaz në Pejë në drejtimin Pedagogjik.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ka qenë kjo periudhë politikisht? Po mendoj ka qenë periudhë pas Luftës së Dytë Botërore, por edhe një kohë e ndryshimeve t'mëdhaja. Qysh e keni përjetu?

Zymer Neziri: Po në kohën kur unë isha në fillore domethanë në atë fazën e parë tashma veç ishin përfunduar shpërnguljet për Turqi, jo krejtësisht, por përfunduan ajo faza e madhe dinamike. Si t'themi që u përgaditë gjatë nga pushtimi jugosllav me trysninë e madhe të burgosjeve pastaj të... të dëmtimit të trupit të njerëzve, pra nga rrahjet e mëdha në emër të aksionit të armëve ajo veç përfundoi. Ku edhe familja ime ishte natyrisht në shënjestër dhe barrën e madhe e mbante babai se ishte më i riu ndër vllazër. Dhe nga presioni i madh kjo familje, kjo familje paraqitet për t'shkuar në Turqi, dhe në Shkup atje bën pazar një shtëpi, e qet fjalën në Pejë se po i shesim të gjitha, po shkojmë në Turqi edhe hiset në Rugovë që i kemi edhe në Pejë edhe në Zahaq. Tash ky presion natyrisht u ndal pakëz, sa kuptohet ata sa dihet, sepse tash ma e dinin se kjo familje nuk do t'jetë ma aty, e paraqiste një familje shumë të madhe si i thonë, "Nga Peja deri në Dri edhe nalt nga Peja deri në Qafë të Çakorrit".

Dhe këso kohe natyrisht me gjeturinë shumë të madhe të axhës Bekë, kështu quhej ai pra, e shmangi një tragjedi të themi familjare, sepse parashikohej një kushëri dhe axha im, që ka qenë edhe në kufi pra tërë kohën, por ka qenë edhe ma heret edhe ka marrë pjesë edhe në kryengritjen në Luftën e Parë Botërore, ata parashikoheshin që të, që të menjanohen në kufi pra të likuidohen. Njeriu që e morri përsipër likuidimin e tyre ishte një njeri që hynte në familjen tonë, por ai njeri ishte besnik i familjes

sonë dhe e tregon qëllimin e pushtetit se duhet të likuidohen pra, Kasan Fazlia, pra axha im dhe Shyt Ahmetaj, pra kushëri. Dhe i thotë kushëritit, “Meqenëse jemi moshatarë, po të tregoj në besë. Këto pare qe po m’i sheh në dorë janë dhanë për krye tat edhe për kryet e Kasan Fazlisë. Prandaj,” thotë, “gjysën po t’i jap, merri hup dika, mos trego kah shkon sepse ndodhë që mua më rrahin shumë dhe pastaj do të tregoj”. Dhe ai natyrisht është larguar në drejtim të Rozhajës pastaj ka vazhduar për Kotor, ka jetuar një kohë ta gjatë atje, ka ngarkuar ka shkarkuar anije dhe kështu është mënjanuar si me thanë likuidimi i tij. Kurse axhës i thotë, “Rri ti te shpia edhe mos lëviz shumë dhe thuj që po më dhem kama”, se ka qenë edhe i plagumë në luftë. Dhe kësisoji pastaj axha e sheh se domethanë shpëtimi i vetëm t’i bahet një lojë pushtetit jugosllav se [kinse] po shkojmë në Turqi dhe ashtu edhe vepron.

Siç thashë edhe shkon në Shkup atje banë pazar domethanë ni shpi, paraqitet për nxjerrjen e letrave e tjera e tjera. Domethanë, kjo ishte një fazë natyrisht shumë e randë, familja punonte shumë, të gjithë domethanë ishin të zotët për t’mbjatur si thojnë disa familje të tjera me punën që e bënin, por shteti me taksat e veta pra, me tatimin e rëndë i merrte të gjitha, merrte çdo gja. Ne kishim edhe një mulli aty në Kapeshnicë dhe dy mullinjë të tjerë i mbante familja me qera. E kemi pasur një mulli tjetër në një shtëpi-kullë menjëherë mbi këtë që e kishim këtu në qendër, por pushteti e merr mas luftës dhe thotë, “Keni mjaft!” Domethanë e bon nacionalizimin e pronës pra, të mullirit dhe të shtëpisë dhe ajo ka qenë sigurisht koha më e rëndë e ushqimit të familjes pra, kur mulliri bie fjala ka punuar 24 orë, por blojën thonë e merrnin për ushtri dhe roja partizane ruante te dera. Domethanë, familja ka vuajtur për bukën e gojës, kjo ishte vuajtja e dytë për bukën e gojës që e ka përjetuar brezi i babait tim, domethanë taman ishte koha kur kam lindur unë, dhe vuajtja e parë ajo e randa është në kohën e Austrisë, pra kur e largojnë pra Malin e Zi nga Rugova, nga Peja me rrethinë, por austriakët thonë e mblodhën ushqimin për ushtri dhe natyrisht popullsia mbeti, mbeti pa bukë.

Puna e pasjes nuk ishte një punë me peshë për familjen tonë, por familja jonë fatmirësisht gjithmonë ka pasur edhe në rrethana shumë të vështira ka pasur, meqenëse bashkohej forca dhe fuqia edhe mendore edhe fizike, por edhe e pronës. Domethanë, bashkohej me një pikë, me një vend dhe kishte, kishte mjaft, kishte edhe për t’u dhënë të tjerëve. Bie fjala, në Pejë ndoshta jemi ndër familjet e fundit në qytet që kemi mbajtur odë të burrave, po t’i thuash dikujt kemi mbajtur odë të burrave, thotë, “S’është e mundur!” Odë t’burrave kemi mbajtur. Dhe një kohë kishte aq varfëri të madhe në Rugovë sidomos dej në vitin 1969, sa njerëzit domethanë nuk kishin mundësi për t’i prituri tërë natën kur vinin me një landë në krah dhe që e shitnin në mënyrë ilegale pra, sepse prerja bëhej ilegale. Por, për të mbijetuar ata e banin me kohë të gjatë me orë të tëra, bie fjala për t’mbrritur në Pejë dhe ata duhej t’strehohen dikun dhe natyrisht strehen e sigurtë e kishin n’familje tonë. Në një kohë nuk mbyllej dera fare, kush t’vjen, vjen, hyn edhe flen edhe çohet edhe shkon. T’njejtën odë të burrave e kemi mbajtur edhe në Siperan pra, në Zaraq për Drenicën, për Llapushën sidomos për pazar t’vogël tmërkureve, për pazarin e madh t’shtuneve, me thënë praktikisht nuk ishim 70 po ishim, ishim rreth 100 pra.

Pjesa tjetër e presionit natyrisht ishte mjaft e madhe për shkak se, për shkak se në rrjedhat e mëhershme si t’gjitha familjet tona edhe kjo familje pra pësoi, prandaj pushteti, për ta pushteti ishte njësoj si në kohën e Jugosllavisë së Dytë pra në kohë e Titos siç quhet, si në kohën e Jugosllavisë së

Parë apo në kohën e Kralit apo Mbretit si edhe ma herët pra gjatë pushtimeve të Malit të Zi në krahinën e Rugovës pra dhe të Pejës me rrethinë apo të Dukagjinit verior deri në Gjakovë ishte njësoj. Domethanë, nuk kishte ndonjë dallim ideologjik, të themi këta janë partizan këta besojnë në komunizëm, këta nuk janë partizan këta besojnë bie fjala në Gjurishiqin at' komandatin e tyre bie fjala, e... Domethanë, nuk kanë pasur dallim, prapë rasti konkret është Lufta e Dytë Botrore nuk i lejojnë, bie fjala për t'u afruar aty, por edhe gjermanët nuk ua kanë marrë armët, por as italianët. I kanë pra në roje të kufirit dhe kësi soji pra, kur vjen puna pra për t'kaluar brigada aty pari, këta nuk e lejojnë brigadën. Thojnë, "Jo, u lamë juve", ishte fjala për një brigadë shqiptare, "u lamë juve, ata edhe këta janë partizan, ju keni bashkëpunuar me ta" edhe vijnë, "për ne janë njësoj si çetnikë, si partizianët e Malit të Zi". Domethanë, kishin një koncept të formësuar me kohë edhe me të vërtetë ai ishte koncept shumë ma i drejtë sesa koncepti i brezit tim që në fillim mendoj se mund t'jetë ma ndryshe. Mirëpo, nuk doli ndryshe, doli i keq edhe për neve. Prandaj edhe brezi im që u rrit në kohën kur në Pejë shkruhet edhe statuti i parë i bashkimit të trojeve shqiptare pra...

Erëmirë Krasniqi: Nga kush?

Zymer Neziri: Nga Adem Demaçi, Ramadan Shala, Ramadani ishte përgjegjës për Komitetin e Pejës, kjo ishte në fillim të viteve '60 dhe këso kohe ne rriteshim, domethanë jo me ta, por rriteshim me guximin e tyre që bënë diçka. Ajo diçka ishte bie fjala shpërndarja e flamujve në Pejë dhe një prej flamujve i vendosur në lokomotivën e trenit në Pejë i cili vazhdon rrugën e vet dej afër Beogradit atje natën. Dhe kjo ishte ajo dhe t'i thuash dikujt, "Jjo ishte një lojë me flamuj, thotë si është e mundur t'luni me flamuj dhe çfarë fitimi kanë pasur?" Flamuri, shej si me thanë ma identitare e shiptarve gjatë shekujve, natyrisht një identitet i flamujve edhe të Evropës edhe të botës, meqenëse se Evropa nuk ka flamur ma t'moçëm se flamuri shqiptar e ka vetëm flamurin e Danimarkës, dhe ky i yni si flamur mbar kombtar i vitit 1444 pra i datës 2 mars kur Skenderbeu bahet pra prijës domethanë i krahinave shqiptare dhe prijës, prijës si me thanë i luftës dhe i paqes. Domethanë nga ajo kohë flamur shumë i moçëm dhe bashkë me flamurin e Iranit hin në rradhët e flamujve më t'vjetër të botës, domethanë shteti Jugosllav e ndalon. Dhe natyrisht për një flamur ti bëje vite, vite burg dhe unë pra brezi im është rritur pa flamur pa shenjë indentitar kryesor kombëtar dhe natyrisht ai brez neve na ngjalli, na dha zemer dhe sigurisht që pasi mbarum shkollën e mesme, studentë t'vitet t'parë eventualisht ishte viti i dytë, ne organizuam demonstratat e para të pas luftës së dytë botërore në Jugosllavi pra, në viset tona shqiptare saktësisht në Prizren, unë atëherë isha student...

Erëmirë Krasniqi: Në cilin vit?

Zymer Neziri: ...po në vitin 1968, në muajin tetor me datën 6. Kjo ishte demonstrata e parë. E dyta ishte në Pejë.

Erëmirë Krasniqi: Cilar kanë qenë kërkesat?

Zymer Neziri: Kërkesat themelore kanë qenë Kosova Republikë. Por, ka pasë kërkesa për vetëvendosje, për universitetin, kërkesa për barazinë e shqipës me serbishtën, kërkesa për punësimin

e tjera, tjera, të cilat u realizuan një pjesë e tyre. Por, kërkesa kryesore Kosova Republikë nuk u realizua shkakut se elita politike shqiptare nuk ishte e gatshme për Kosovën Republikë. Ishte e gatshme ta ketë në posedim, si i thonë (buzëqesh) ta shfrytzojë, mirëpo s'ishte e gatshme edhe t'luftoj për te po edhe ata u ndalën, fatkeqisht edhe elita intelektuale u ndal. Sado që ishin shumë pak dhe ne mbetëm vetëm, studentët mbetën vetëm, nxansët e shkollave t'ëmësme natyrisht, moshat e rritura, mbeti vetëm populli. Dhe ashtu filluam dhe bamë mirë, dhe sigurisht ai ishte hapi i parë pas Luftës së Dytë Botërore, me mijëra e mijëra njerëz të dalin bie fjala të protestojnë, të demonstronjë dhe të kërkojnë Kosovën Republikë. Dhe pastaj natyrisht ne e kemi menduar se ky do të jetë hapi i parë i bashkimit, sepse deri në brezin tim, bie fjala brezi i Demaçit ata kërkonin bashkimin e trojeve. Dhe ne gjetëm një rrugë tjetër që noshta s'e gjetëm ne, por u gjet ajo vetvetiu; që nëse bahemi republikë dhe këta janë republika dhe e dinim se nuk do t'jetojnë bashkë atëherë një ditë kur do të ndahen këta do të ndahemi edhe ne. Këta u ndanë si e dini pra me përgjakjet ma t'mëdha që ndodhën në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore dhe natyrisht në ato përgjakje ishte edhe hisja jonë noshta edhe ma e vogla nga ajo çka planifikohej për masakrimin e kti popullit.

Erëmirë Krasniqi: A keni qenë të përsekutim gjatë aktivitetit politik të '68?

Zymer Neziri: Po, natyrisht, ne t'brezit '68 nuk kaluam aq keq sa kishin kaluar brezat para nesh, nuk kaluam aq keq. Meqenëse ishte një klimë politike pak më e zbutur në qarqet e Federatës Jugosllave, ishte më e zbutur dhe n'atë zbutje ne kaluam, kaluam ma lehtë. Mirëpo, nuk kaluam lehtë në të tjerat, bie fjala nuk kalove lehtë po e zamë me punën, ne ishim studentë por edhe punonim, natyrisht na larguan nga, edhe nga puna pas burgosjës dhe pastaj kishim edhe probleme të tjera.

Erëmirë Krasniqi: Sa ju mbajtën në burg?

Zymer Neziri: Burgu nuk ka zgjatur shumë, p'e zam për neve, për neve në Pejë atje ka zgjatur vetëm, vetëm një muaj, një muaj, në Prizren 15 ditë, një muaj edhe në Pejë kishte nja 15. Mirëpo, këto të tjerat pastaj vazhduan dhe një hakmarrje tjetër ndaj brezit '68, por edhe [ndaj] brezit të Demaçit që posa filloi të dal nga burgu, ishte viti '72 vjeshtë pra. Kur në këtë vjeshtë u zbatua një letër që erdhi nga...Komiteti Qendror, pra nga vet Titoja që i thonin, "Letra e Titos", dhe aty pastaj u bë një spastrim i madh sidomos në arsim. Dhe nga shkollat fillore dhe të mesme përjashtuan rreth 250 arsimtarë, që ishin domethanë, o nga organizata e Demaçit, o simpatizues të organizatës së Demaçit, o të burgosurit të asaj organizate, o pjesëmarrës të demonstratave '68 pra për Kosovën Republikë. Dhe domethanë, ishte një grup shumë i madh pra, Kosova pësoi shumë pra në vjeshtë 1972, kjo zgjati deri në mars '73.

Në mars '73 ishte nën shënjestër Univerziteti i Prishtinës, i posa themeluar pas demonstratave '68 që ishte kërkesë poashtu e demonstratave, dhe ishin nën shënjestër njerëzit me emër të madh, sidomos atdhetarët, Sami Peja i burgosur politik, Fakultetin Juridik, Ekonomik, Hajrullah Gorani poashtu i burgosur politik i brezit të pas Luftës së Dytë. Pastaj edhe Mark Krasniqi nën shënjestër, për shkak se merrej si ndër profesorët që i kanë përkrahur kërkesat e studentëve, po ishin edhe vllazërit Agani, profesorë pra, tash të ndjerë, profesor Qosja e të tjerë. Pra kishte shumësisht në shënjestër, po në fund, në fund... komiteti...

Erëmirë Krasniqi: A keni mujt me mbajt statusin e studentit në këtë kohë? A keni mujt me i vazhdu studimet?

Zymer Neziri: Po, p'e përfundoj, po kuptoj. Po përfundoj se duhet tash kamerën ta ristartoj më sigurisht.

Noar Sahiti: Jo, mundeni me përfundu fjalën veç mas ksanja domethonë edhe tre minuta i bjen që kemi kohë.

Zymer Neziri: Po mirë, përfundoi ajo si përfundoi dhe për fat të mirë domethanë lista nuk u zbatua e përjashtimeve nga puna në fakultete dhe institute. Me përjashtim të një rasti, ai rast isha unë fatkeqsisht, por edhe fatmirësisht pse isha vetëm unë e jo edhe të tjerët. Natyrisht më larguan nga ky Institut dhe në këtë Institut jam rikthyer pas 19 vjetësh, po gjatë asaj periudhe sigurisht kam punuar për Institutin, e kam ruajtur kondicionin intelektual, profesional, kam punar shumë, kam punuar nga dy orare edhe tash punoj dy orare se jam mësuar t'punoj edhe kjo ishte ajo pjesa, si me thanë që lidhet drejtpërdrejt me rininë e hershme edhe me Lëvizjen Studentore të vitit '68.

Pjesa e Dytë

Zymer Neziri: Po unë fillimisht kom qenë student në Prizren në shkollën e lartë pedagogjike të Prizrenit, atje jam regjistruar në vitin 1967. Në Prizren kam shkuar edhe me shkollë të mesme Normale të kryer, ajo ishte shkollë pesë vjeçare. Unë i mbarova katër [vjet] domethanë gjimnaz Pedagogjik kurse vitin e pestë e mbarova këtu në Prishtinë, natyrisht pa shkëputje nga puna dhe punova një vit mësues. Po aso kohe kisha dëshirë t'shkoja në Zagreb. Tash po e them këtë për shkak se nuk kisha ndërmend, domethanë të ndalem vetëm te Gjuha dhe Letërsia Shqipe, por të regjistroj Linguistikën në Zagreb. Dhe u paraqita atje, por isha pa bursë, pa kredi si zakonisht që ishim të gjithë atëhere dhe nuk shkova në Zagreb, por punova një vit mësues në Zllakuqan të Klinës dhe mbarova dhe vitin e pestë këtu.

Pastaj prapë në Zagreb nuk u ba t'shkoj dhe u paraqita ushtar. Kreva ushtrinë dhe pas shërbimit ushtarak përsëri nuk u ba t'ndalem në Zagreb. I morra dokumentat erdha në Prizren, ku mundësia për kryerjen e shkollës shpejtë, për ata që natyrisht punonin dhe kishin dije ishte e mirë për shkak se gati çdo muaj kishte provime. Dhe unë e shfrytëzova këtë t'drejtë, domethanë student me korrespondencë dhe marova punë ma shpejtë në Prizren. Natyrisht kom ndëgjuar ligjëratat e verës me program të shkurtuar dhe kështu brenda një motmoti, afërsisht kështu, kam përfunduar në Prizren. Por gjatë kësaj kohe aktiviteti ka qenë shumë, shumë i dendur. Përveç punës mësimore pra që bëhej, aktiviteti ishte i dendur, atje gjeta domethanë studentë, brezin e Meriman Vrasë, të Isa Demajt, Fadil Sylejmanit, të Rafet Ramës dhe të tjerëve, t'cilët kishin punuar edhe në grupin dramatik, "Plakun e Maleve", kishin punuar në grupin e... grupin e studentëve, domethanë grupin letrar. Dhe domethanë, ishte një

aktivitet natyrisht ndër më të mirët domethanë që zhvillohej në Kosovë aso kohe, por aktiviteti kombëtar ishte natyrisht i dorës së parë.

Dhe në ditën e flamurit siç e përmendëm, atij flamurit për t'cilin kishim pak njohuri tash do t'ua tregoj edhe një që pastaj u bë anekdotë. Natën e flamurit me datën 27 nëntor, '67 thamë që po e shënojmë ditën e flamurit, një grup pak më i besueshëm, rreth dymbëdhjetë ishim po menduam edhe tjetrën, se në qoftëse na heton policia natyrisht do t'na arrestojnë dhe thamë, “Ç’po themi? Po themi se po festojmë notën e Zymerit”. Unë dola në Letërsi Popullore te profesor Demush Shala, m’kishte vlerësuar me dhjetë me shkrim pastaj edhe me gojë. Dhe thamë, “Po e vlerësojmë kështu situatën, dhe besojmë se kalojmë mirë sepse Zymeri punon, merr një rrogë dhe ka mundësi edhe t’na qarosë.” Kështu thamë, por ajo nuk piu ujë te policia sigurisht.

Ne u bëmë bashkë dhe pas mesnate erdhi policia na rrethoi, na arrestoi, na mbajti rreth një muaj, dy të tjerë, Isa, Merimani, ata i mbajtën disa ditë më shumë, rreth pesë javë, pastaj lënda te prokurori rreth gjashtë muaj për t’ngritur ni aktakuzë domethanë për vepër penale. Por gjatë tërë kësaj kohe edhe pasi dolëm ne planifikonim demonstratat e vitit ‘68 dhe ishim gati me datën 10 qershor, ‘68 që t’shënojmë kërkesën e parë për Kosovën Republikë. Mirëpo, nga përvoja që nuk e kishim dhe nga dija mjaft modeste për t’u gjetur për punët e ilegalës, na hetuan, na mbeti kurora pa e çuar në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe na mbeti pa dalë në rrugë. Po them, “Po e lamë për një datë tjetër e cila nuk do t’jetë datë që e di pushteti, nuk do t’jetë po e zamë dita e flamurit, as kjo e Lidhjes së Prizrenit, por do t’jetë një datë tjetër që ata nuk do t’i bien në fije”, ashtu dhe ndodhi dhe caktuam saktësisht datën 6 tetor, 1968.

Tash kjo që thashë në fillim (kollitet) është ajo pjesa ma me interes, që vajzat që e morrën për ta qëndisur flamurin, taman Marigonat e vitit ‘68 në Prizren, kanë menduar se shqiponja nuk i ka...{shpjegon me duar} kështu kokat e lshuara në të majtë dhe në të djathtë, por shqiponjat i kanë kokat e kthyer brenda dhe thanë, “Po tosknia dhe gegnia qysh ban me shkue njana knej tjetra anej? Tosknia dhe gegnia shkojnë kështu, por edhe shqipëtarët e jugut dhe t’veriut shkojnë kështu. Duhet t’jenë bashkë”. Kjo ishte ajo pjesa që ato e kishin menduar, e kishin marrë me mend dhe na vunë para dileme. Pastaj vajtëm në familjën e Merimanit dhe morrëm një napolon, kështu quheshin t’hollat e Luftës së Dytë Botërore që ishin në përdorim dhe aty ishte shqiponja dhe natyrisht ua tregum domethanë shqiponjën, se shqiponja është kështu {shpjegon me duar} dhe jo kshtu, po, dhe (buzqëqesh) u bindën dikur.

Domethanë flamuri është qëndisur, flamuri i Prizrenit pra i 6 tetorit, ‘68 është qëndisur. Flamuri i Suharekës është punuar, është punuar, është vizatuar dhe pjesa qendrore e tij është mbushur me tush. Haxhi Bajraktari e punoi dhe ai e morri përsipër natyrisht Therandën, pra Suharekën kurse flamurin e Pejës kishim kohë për t’menduar dhe gjetëm një zgjidhje, natyrisht morrëm një flamur fabrike, natyrisht i prodhuar në fabrikën shqiptare, sepse nga ato burime ne merrnim dhe libra aso kohe. Është një, prapë e kalova [më] parë.... Ne kemi marrë dhe libra n’shkollë të Lartë Pedagogjike dhe natyrisht unë kom pasur fatin t’marrë, bije fjala “Sintaksa” e Stefan Priftit që ishte e para, ndoshta teksti i parë që e patëm brenda. Dhe pastaj atë tekst, kur koha e shumëzimit mungonte siç osht’ tash, ne e kemi

përshkruar me dorë, edhe dy kopje me dorë i banëm, 24 orë punonin grupet, t'lodhej dora ty, vazhdonte tjetri.

Dhe kthehem te flamuri, ai flamur është gjallë pra, flamuri i Suharekës, flamuri i Pejës ka qenë gjallë deri n'luftën e fundit pra dhe është djegur, është djegur pra në një shtëpi ku është djegur dhe krejt shtëpija. Kjo periudhë ka qenë natyrisht një prej periudhave, një prej periudhave më të shëndetshme, po them kështu, politike të rinisë shqiptare dhe ndër më të guximshmet, sepse po them prapë, për herë të parë pas Luftës së Dytë Botërore rinia shqiptare del në rrugë atëherë kur nuk ishte klasa politike me ta dhe fatkeqësisht edhe ata pak intelektual që i kishin nuk ishin me ta.

Dhe dalja në rrugë natyrisht planifikohej që kushton shumë, mund t'kushtoj edhe me kokë, por është fat i madh se në Prizren kemi pasur disa mijëra njerëz mrapa, dhe jo një orë e dy, por sigurisht marshi në qytet ka zgjatur rreth tri orë e gjysmë. Katër orë me flamur kombëtar përpara, atë flamurin ato Marigonat tona të them të vitit '68 që e punuan me dorë, edhe deri te Lidhja e Prizrenit pastaj kur jemi kthyer sepse nga sheshi jemi nisur. Ka pasur edhe fjalime, një fjalim është mbajtur nga Bashkim Laqi, që ishte kryetar i zejtarëve të qytetit të Prizrenit, një prej veprimtarëve ma t'mirë që tash fatkeqësisht nuk jeton. Pastaj një fjalim tjetër është mbajtur nga Gjergj Camaj që ishte sekretar i Lidhjes së Studentëve, aty ndër ne kom pasur fatin t'jem autor i atyre teksteve, dhe natyrisht tekstet nuk janë veç personale por janë edhe grupe sepse i kemi shqyrtuar bashkë, i kemi redaktuar bashkë dhe në fund u kemi dhënë dorën përfundimtare dhe ato si të tilla janë thanë pra në tubimin që e kemi mbajtur pra, para ndërtesës së Lidhjes Shqipëtare të Prizrenit.

Pas kësaj, natyrisht ne nuk kemi pasur ditë të mira dhe do t'thotë mue më larguan pastaj nga puna pas arrestimit në Pejë, se mu m'ra në Pejë hise, dhe Pejën natyrisht e kreu me frigën shumë të madhe. E morra [përsipër] edhe pse kisha frigë, sepse Peja mund t'dështojë dhe ky mund t'jetë një prej dështimeve më të mëdha, sepse unë bije fjala pata përmend Gjakovën, m'thanë, "Jo, Gjakova lunë rendit kollaj se jonë krejt shqiptarë, por Peja lunë rendit vështirë se janë 39% malazet dhe serb". Dhe ashtu ishte, domethanë për bamja e popullsisë ishte mjaft e lartë, domethanë popullsisë së, popullsisë sllave, dhe kishin frigë nga ata, shumë ma shumë se nga policia, kishim frigë pra nga civilët që do t'tentojnë t'na i marrin flamurin, t'na i shkelin flamurin, t'na i djegin flamurin dhe ne mendonim për flamurin e jo për vete. Prandaj në Pejë bie fjala kemi krijuar edhe njësitin për mbrojtjen e flamurit dhe ai njësit natyrisht ka pasur nevojë për ta treguar veten te stacioni i trenit kur provuan t'marrin flamurin, jo serbët e malazet po vetë policia.

Ai flamur është vendosur në kulmin e Shkollës Normale në Pejë dhe aty kanë ardhë pastaj zjarrëfiksit për ta marrë, domethanë për t'hipur lartë me shkallët e tyre dhe për ta marrë nga, nga kulmi i shkollës. Po ne e kishim planifikuar se nëse vijnë ata dhe donë ta marrin atëherë ne do t'u marrim prapë, para tyre domethanë do ta heqim dhe e kemi hequr natyrisht flamurin ndërmjet shkallëve të brendshme që ishin të ndërtesës dhe kështu ai flamur ka shpëtuar deri në pranverë 1999, flamuri i Pejës, por është djegur në një shpi, po në shpinë e një shokut tim t'asaj kohe, shpinë e Ramadanit, Ramadan Blakaj.

E tash ky brez, ky brez natyrisht jetoi keq. Unë erdha këtu në Prishtinë, vazhdova shkallën e dytë, pak provime pranuan, shtatë provime dhe të tjerët u riprovuan. Kishte edhe provime të reja, por edhe këtu kalova shpejtë, gati për një motmot kalova dhe mrrita, mrrita në vit të katërt, meqenëse kohë kisha, pa punë isha. Dhe pas mbarimit t'studimeve konkurrova në disa vende pune, konkurrova edhe në Institut këtu, konkurrova edhe në Bankën e Bashkuar të Kosovës e pos... posathemeluar aso kohe, selia ka qenë në qendër aty ku është tash Banka e Lublanës. Dhe më pëlqente në Institut këtu, e doja punën domethanë kërkimore-shkencore dhe u përcaktova për te. Dhe pastaj doli se e kisha dhanë provimin atje, domethanë në bankë, provimin domethanë testet i kisha maruar dhe kisha zanë venin e parë.

Kishte vetëm një vend punë, kurse këtu në Institut poashtu një vend pune ishte te profesori Anton Çetta, domethanë asistent për folklor dhe etnologji, vetëm dy vetë, unë dhe ai. Unë u përcaktova për këtu, por natyrisht kërkova dhe një leje t'themi nga familja dhe e di që babai më tha, "Ke punë me thmi," domethanë me studentë, thashë, "Jo, profesori po..." Ai jepte mësim në fakultet këtu, kishte frigën se a m'qesin prej pune, meqenëse unë gjatë studimeve pata tri përjashtime nga puna. Po, një, ajo që thashë në Klinë, pastaj përjashtimi tjetër ishte në Lipjan, një tjetër në Pejë, domethanë ne hynim në punë, por si të hetonin, "Del, del, del!" Edhe kur ti punoje mirë domethanë, "Del, del se je i papërshtatshëm!" Domethanë, moralo-politikisht [siç] na quanin ne në aso kohe, dhe domethanë kishte frigën a m'qesin prej Institutit. Thashë, "Jo, aty nuk kam punë me thmi." Dhe erdha këtu, t'ardhunat natyrisht kanë qenë këtu siç kanë qenë, bie fjala në gjimnaz, asistenti domethanë paguhej aq, ndërsa n'bankë ishte pagesa dy-tre fish më e madhe, sigurisht edhe mundësia për t'marrë banesë, por nuk u përcaktova për bankën erdha këtu.

Këtu siç fola edhe në pjesën e parë, në spastrimet që u banë në vjeshtë '72 deri në pranverë '73 atëherë n'atë valë mua më larguan nga Instituti, kjo ishte ajo pjesa e studimeve që kom qenë edhe student edhe s'kom qenë student, se kom kalu nëpër valë si thonë dhe studimet këtu, këtu bie fjala kom dëgjuar ligjërata te profesori Isak Shema, që ishte një prej provimeve ma t'vështira në fakultet sepse ishte edhe letërsia bashkë në një vend bashkë me, bashkë me prozën dhe poezinë dhe me dramën që tash janë të ndara në provime të veçanta. Por Letërsia Jugosllave ishte prapë një provim shumë, shumë i randë ku rrishin rreth njëzet e katër mijë faqe tekst nga letërsia sllovene dej tjetra maqedone edhe aty kalohej shumë vështirë dhe ka qenë një prej katedrave më të zorshme domethanë, t'marrsh një diplomë për Gjuhën Letërsi Shqipe. Dhe unë me atë leximin e madh që e kisha kryer në shkollimin e mesëm, sidomos për serbishtën, këtu nuk pata problem, nuk pata nevojë t'lexoj fare, domethanë me atë dije t'gjimnazit e kalova Letërsinë Jugosllave. Për letërsinë tonë nuk kisha prapë ndonjë problem dhe domethanë kjo ishte ajo faza e parë e studimeve në Prizren dhe e dyta këtu në Prishtinë.

E treta ishte kohë e vështirë për mua, ka qenë sigurisht ma e randa e jetës sepse nga Instituti më larguan, domethanë isha pa t'ardhura. Një rrogë që e kishim në familje edhe atij nga fakulteti ia zbritën rrogën vetëm me shkollë të mesme, sepse i përkrahi kërkesat për Kosovën Republikë dhe thanë, "Nuk paguhesh ma me rrogë të pedagogut," pedagogjinë kishte mbaruar në Shkup, "por do t'paguhesh me rrogën e mësuesit!" Dhe ashtu mbeti. Motra studente në Prishtinë, vëllau student në Zagreb, domethanë t'ardhura nuk kishim, kishim shumë, gjithçka kishim, por t'holla nuk kishim në qarkullim.

Dhe kjo ishte një pengesë për mua dhe natyrisht unë në kushte shumë të vështira mbarova shkallën e tretë, këtu katër semestra...

Erëmirë Krasniqi: Cilin vit?

Zymer Neziri: Saktësisht është vjeshta '72, vjeshta '72 dhe deri në, deri në pranëverë '74. Ka qenë seria ma e mirë, si të themi e përgaditjes së kuadrove në Albanologji për Gjuhën dhe Letërsinë Shqipe, e përgaditjes po them profesionale të ligjëruesve nga Tirana që kanë ligjëruar në kuadër të landës së profesorit Qosja. Kanë ligjëruar shtatë-tetë, kanë ardhë nga Tirana nga brezi Bihikut, bie fjala kështu këndej. Pastaj ligjëruesi për Pesë Estetikën nga koha e vjetër dhe deri në kohën moderne ka qenë një profesor i shkolluar, një specialist i Gjermanisë, Nigeo Gestardollov, i cili pastaj bëhet edhe antarë i akademisë, kryetar i akademisë të shkencave të Maqedonisë. Pastaj, teoritë poashtu i ka ligjëruar një profesor jahudi nga Sarajeva, një Ivo Tartala dhe kësi soji domethanë ka qenë një, një, një, një dije, një dije vërtetë e përmasave, përmasave evropiane. Po, ishe fat i madh domethanë të jesh student n'atë periudhë, por ka qenë fatkeqësi sepse, sepse disa nuk i kishim kushtet. Ne që kishim kaluar nëpër valë, nëpër valë në demonstrata, pra të burgjeve, të përjashtimeve nga puna, ne ishim keq.

U dhanë dhjetë bursa sa e mbaj n'mend unë nga Bashkësia Krahinore e Arsimit të Shkencës apo s'e di si e ka pasë emrin krejt të saktë, dhe ato mbetën, disa nuk i morri askush sepse ne që ishim domethanë të procesit të, të Lëvizjes Studentore ne nuk na i dhanë. Dhe natyrisht unë kam shfrytëzuar, bie fjala dhe Hanin e Dilit në Prishtinë, se një natë për të bërë, bie fjala këtu një natë që unë për t'vazhduar ligjeratat ditën e nesërme. Dhe në këto rrethana, domethanë kam përfunduar shkallën e tretë dhe natyrisht vullnetin e madh e kisha, por krahas vullnetit kisha edhe një inat shumë, shumë të madh të cilin e kam edhe sot dhe sigurisht ai inat mu më ka nxjerrë në sipërfaqe këtu ku jam sot. Se ndryshe do t'përfundoja shumë herët siç kanë përfunduar shumë, me dhjetëra e dhjetëra njerëz kanë përfunduar keq sepse i kanë ndalur studimet, nuk kanë vazhduar përpara edhe janë mjaftuar domethanë me ato, me ato që i kishim atëherë.

Erëmirë Krasniqi: E qysh ju gjeti viti 1989?

Zymer Neziri: Po, shkallën e tretë posa e përfundova unë konkurrova, po përfundoj edhe këtë, konkurrova për fondacionin *Fulbright* dhe konkurrova që doktoratën ta përfundoj në Univerzitetin e Harvardit në koleksionin e *Milman Parry-t*, është një prej koleksioneve ma të mëdha në botë të Ballkanit Perëndimor. *The Milman Parry Collection* i ndërtuar në vitet '32, '35, në Ballkanin Perëndimor me materiale boshnjake, shqipe, kroate dhe serbe. Dhe aty une mendoja të shkoja dhe fatkeqësisht në atë koleksion vetëm një doktoratë shqiptarë ka mbrojtur në vitin e largët 1967 nga Gjon Kolsti [John Coles] i lindur në Amerikë dhe jeton ende në Teksas, jeton në... tash është profesor në pension i Univerzitetit të Austinit. Dhe unë mendoja të jem, të jem i dyti.

Kjo nuk ndodhi, sepse në Pejë më thanë, më thanë “Nuk të takon e drejta e pasaportës”. “Por, pse?” “Ke dhjetë vjet ndalesë”. U ankova në Prishtinë, thanë, “Mirë ta kanë ba.” Si të thuhet kështu... Dhe natyrisht nuk pata pasaportë dhe nuk dola, dhe kjo shkoi, domethanë shumë gjatë. Tek pas luftës kam shkuar në Harvard në vitin 2002, domethanë mas 28 vjetësh. Po, dhe natyrisht ende jam bashkëpunor

i jashtëm i tyre, kam punuar një projekt, projekti është në përfundim e sipër t'atyre materialeve të viteve '30.

Pra kjo ishte ajo koha e vështirë për neve sepse ne kishim vazhdimisht pasoja, domethane s'je në burg, je i përcjellur ditën e natën, je në punë, s'bën t'punosh në arsim, s'bën t'punosh bie fjala në institucione shkencore mund të punosh në administratë. Dhe unë pastaj në bankën që e refuzova punën në vitin '71, prita deri sa doli konkursi, u hap edhe një vend pune në vitin '77, dhe n'bankë aty pastaj kam vazhduar punën e përkthyesit, të lektorit dhe kam punuar aty 14 vjet, por para dreke për bukë, e pas dreke për këtë Institut. Prandaj u mësova t'i mbaj dy orare pune. Të premteve në terren dy qind kilometra rrugë apo jo i bëja në bjeshkët e Rugovës dhe mblodha materialin për disertacion doktorate dhe ajo zgjati diku rreth 700 ditë pune, ose dikun afërsisht rreth tetë vjet, dhe tash është koleksioni më i madh që osht' krijuar ndonjëherë ndër shqiptarë nga Gustav Majeri e këndej vitit 1897.

Po them është ma i madhi sepse koleksionet e tilla rajonale nuk janë krijuar ndër shqiptarë, dhe unë e krijova edhe formën e hulumtimit, edhe formën e shkrimit, edhe formën e inçizimit. Ai material ruhet sot në Institut. Për fat të mirë një kopje, natyrisht kam edhe një kopje tjetër sepse ka qenë rrezik të zhduket, një kopje saktësisht që ishte këtu kopja arkivore e kanë marrë kur u plaçkit Instituti në paranevërë '99. Një kopje tjetër është djegur në shtëpinë e motrës, aty afër Pejës, në katunin Kliqinë bashkë me bibliotekën që e çuam këtu nga Prishtina. Një kopje tjetër është marrë në Pejë te bashkëpunatori jem Qel Bardhaj, dhe për fat unë kisha edhe një. Përveç njive do me thanë krijova edhe tri kopje po sa filloi lufta në Kroaci. Natyrisht kam filluar me kopje, ato kanë qenë bobina të gjatë dhjetë minutshe, disa edhe njëqindshe, domethanë kam pasur mbi dyqind e dhjetë orë inçizim, domethanë koleksioni ma i madh domëthanë i krijuar ndër shqiptarë nga një rajon. Për fat ai koleksion është gjallë, edhe forma shkrimore edhe inçizimit, kurse forma e botimit jo. Ka vetëm tri vëllime të botuara, vetëm tri vëllime, aty i kam nxjerrë si me thanë Homerët e fundit, Homëret e fundit e epikës legjendare shqiptare, bie fjala në krahinën e Rugovës kam gjetur pesë që kanë ditur mbi dhjetë mijë vargje, por për fat një e kemi botuar këtu me 2011 në Insitutit.

Sa i përketë punës tjetër domethanë gjatë studimeve dhe gjatë përpjekjeve për t'u rikthyer në Institut vërtetë ka qenë shumë e vështirë. Shumë e vështirë ka qenë t'mendosh për Institutin dhe bie fjala, gruan, çikën, djalin, tjetrin djalë, t'i leshë vetun në kohën kur njerëzit pushonin bie fjala t'premtën mas dreke, kalonin t'shtuneve, t'dieleve bie fjala në një sheti, po e zamë ose në ndonjë vizitë. Unë i bëja, po thom s'paku edhe tridhjetë orë punë në terren, domethanë nga këto dyzet për, për t'ardhunat në bankë i bëja s'paku edhe tridhjetë të tjera dhe t'shtunën bashkë me t'premtën dhe të dielën. Tri netë që duhet t'bësh gjumë s'pakut rreth njëzet orë, unë nuk i bëja njëzet, nuk i bëja dhjetë po i bëja edhe shumë më pak se dhjetë. Ka ndodhur natën ta kaloj vetëm me dy orë gjumë dhe kësi soji pra e krijova edhe koleksionin edhe hulumtimet për disertacion dhe kësi sojit krijova njërin ndër koleksionet më të mëdha që janë në Ballkan sigurisht edhe n'Evropë.

Dhe fatmirësisht tash mbarova edhe koleksionin tjetër, por ky koleksion tash doli sa t'gjitha viset e Ballkanit, në pesë shtete ku jetojnë shqiptarët. Doli i barabartë me koleksionin e Rugovës para dyzet vjetësh, domethanë është fjala për një trashëgimi etno-kulturore e shqiptarëve që nuk osht' në ngritje.

Po ajo që ka ndodhur me gjermanët, me nibelungët, me kangët e qesteve të francezëve dej te kalevala e Finlandës, pra do t'ndodhë edhe me ne. Por, shqiptarët megjithatë e kanë filluar këtë mijëvjeçarin e tretë, domethanë, me këtë njësi që hyn në rradhën e bukurive më të mëdha poetike, artisitike pra të botës dhe projektin e kam përfunduar poashtu për UNESCO.

Është i dorëzuar, qeveria rrin, heshtë, thotë, “Du me hi në UNESCO.” (buzëqesh) Po, hin në UNESCO, po trego çka do me çu në UNESCO? Por, nuk është vetëm ky, por ka mundësi që t'bjajmë edhe projekte të tjera. Këta rrijnë, po mendojnë se në UNESCO shkon me pa Barcelonën, bie fjala, me pa një ndeshje futbollit ose Paris Saint-Germain, bie fjala, ose ndonjë ekip tjetër dhe në UNESCO nuk e dijnë se çka dojnë të bëjnë në UNESCO. “Du me shku në UNESCO”, do me shkue, por në UNESCO duhet t'shkosh i përgaditun dhe këta nuk kanë bërë përgaditje fare. Unë fillova projektin, asnjë dokument për UNESCO nuk është miratuar në Kuvendin e Kosovës, bie fjala ai dokumenti kryesor i vitit 2003, bie fjala i Parisit nuk është miratuar, e dorëzova kërkesën, “Po duhet teksti edhe përveç shqip e anglisht, duhet teksti serbisht”. E hartova tekstin serbisht, e dërgova, e evidencova në arkivën e Kuvendit të Kosovës në kohën kur Jakup Krasniqi ishte Kryetar Kuvendi, kurrë atë ditë e sot nuk e kanë miratuar...

Erëmirë Krasniqi: Çka përmbanë ai dokument?

Zymer Neziri: Si?

Erëmirë Krasniqi: Çka përmbanë ai dokument?

Zymer Neziri: Ai është dokumenti kryesorë për trashëgiminë shpirtnore, po i UNESCO-s, i miratuar në Paris, por ka edhe dokumente të tjera, po e zamë për arkitekturën, arkeologjinë bie fjala dhe njësitë e tjera mbi t'cilat ndërtohet domethanë UNESCO dhe pjesa e trashëgimisë. Dhe jo, nuk, nuk i kanë kryer por unë e kreu projektin domethanë që t'konkurrojmë, por e lamë që në qoftëse ne nuk kemi, në qoftëse ne s'kemi status... atëherë statusin e ka Tirana dhe Tirana kryen punën, kryen punën edhe për neve edhe për vete edhe për krejt shqiptarët, por këta nuk pranuan dhe projekti mbeti ashtu dhe pret ditë më të mira që nuk po vijnë njëherë përnjëherë në këto përplasjet e mëdha t'Evropës me vetëvetën. Sidomos me rusët, nuk ka, nuk ka ditë t'mira.

Dhe në kohën kur unë propozova në vitin 2009 ishte ma lehtë, ma lehtë të depërtohet në UNESCO, ka qenë shumë ma lehtë s'paku me këtë njësinë që provuam tash, domethanë jo me status t'anëtarit të Kombeve të Bashkuara, por pa atë status, domethanë t'konkurrosh si rajon. “Jo, na nuk domë, po i bjen kjo si krahinë autonome e Kosovës e Metohisë.” “Mirë.” Edhe tash e provun me krahinën, por e provunë vonë. Dhe në UNESCO natyrisht pritet aty që t'çojmë edhe njësite tjera, kemi valle aq t'bukura, nga vallja shpata e Rugovës dej te kjo e Deli Agushit që luhet anej në viset e juja, anej ka domethanë nga Dardana dhe...

Erëmirë Krasniqi: Kur e keni bo këtë hulumtim n'Rugovë?

Zymer Neziri: Hulumtimin në...hulumtimin në Rugovë e kam nisur në vitin '76, '79, mirë thashë '79, dhe ka përfunduar në vitin '88. Kurse ky tjetri, projekti tjetër prapë me 15 vëllime, ky ka filluar në vitin

2012 dhe ka përfunduar zyrtarisht në 2014. Po unë kam punuar edhe me 15 dhe punoj edhe tash, tash bie fjala para tre javësh pata një inçizim të pesë njëjësive t'këngëve kreshnike të cilat këndohen edhe në Zvicërr nga mërgimtarët tanë. Kurse projekti tjetër i dosjës për UNESCO ka filluar në vitin 2009, 2009, dhe ka përfunduar në vitin 2012. Dhe një, pakëz një dalje e shkurtër është nënditore e trembëdhjetshit të inçizimeve në terren për filmin dokumentar që i banë në krahinën e, në krahinën e Malsisë së Madhe që mbetet në Malin e Zi, pra afër Podgoricës, saktësisht pra në Tuz.

Erëmirë Krasniqi: Po kthehem pak mrapa, mas pari për '81 deshta me folë.

Zymer Neziri: Po, '81 ishte pyetje... E kisha parasysh.

Erëmirë Krasniqi: Mandej ndoshta për Institutin?

Zymer Neziri: Po, në vitin '81, domethanë unë veç isha në bankë, isha punëtor i bankës, Bankës së Bashkuar të Kosovës. Kam punuar në katin e njëmbëdhjetë (buzëqesh), në zyrën 005. Po, dhe aty kam punuar domethanë 14 vjet. Ka qenë në shërbim shumë i mirë, ka qenë në kolektiv shumë i mirë, dhe unë mendoj që ka qenë ndër kolektivat më të mira që i kam takuar në Kosovë, gra, burra, të ri, pleq, t'gjitha kategoritë, të shkolluar deri në shkallën që i thojnë të përgatitjes, të përgatitjes edhe të nivelit, nivelit evropian pra edhe të nivelit botëror. Bie fjala, QLLË-ja, apo Qendra e Llogarisë Elektronike, ka qenë ndër qendrat më të pajisura në krejt Ballkanin Perëndimor. Në kolektiv i mrekullshëm. Edhe me pastrusin, njeriun e parë që e takoje në mëngjes e pije kafën e mëngjesit me shumë knaqësi.

Unë aty domethanë në vitin '81, në demonstratë të '81 isha aty. Po para kësaj, para kësaj, ishte viti '78, viti i shënimit të 100 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Dhe këso kohe, bie fjala planifikoheshin demonstrata shumë të mëdha në Kosovë, të përsëritet edhe në '68, një 10 vjetor sepse nuk doli ajo që e kërkuam, nuk doli Kosova Republikë. Doli Universiteti, u lirua flamuri, u lirua përdorimi i shqipërisë në administratë, dhe pati shumë lirime, mirëpo ishin disa edhe të dorës t'dytë, të dorës së tretë sigurisht për neve ishin shumë të rëndësishme se nuk i kishim, por megjithatë ajo kryesorja nuk u ba. Dhe domethanë '81 ka mund të ndodhë bie fjala edhe vitin '78. Lëvizja ilegale në vitin '70 ka qenë shumë, shumë e gjallë, shumë aktive. Ka pasur shumë burgosje, dhe shumë vite burg janë dhanë, domethanë, në vitet '70 kur llogaritet se në 100 vjet robni, shqiptarët e kishin mirë në vitet '70.

Nuk ka qenë mirë, ka qenë pak, mjaftushëm. Ka qenë keq edhe mjaftushëm. Po n'krahësim me vitet e tjera që pasuan, këto që thatë ju në vitet '80, '90, e deri në luftë, me vitet ma herët, domethanë me vitet '60, '50 për t'cilat folëm, vitet '40 deri te 1912 kur pushtohet krejtësisht Kosova domethanë nga Serbia dhe Mali i Zi. Atëherë, këto ishin prapë po them vite pak ma të buta, por megjithatë, lëvizja e rezistencës, Lëvizja Studentore nuk ka pushuar. Edhe ne kemi vepruar natyrisht, grupi ynë ka vepruar, dhe '81 pra ka mundur të ndodhë edhe para '81. Ka mundur të ndodhë edhe për 100 vjetor. 100 vjetori ishte në arsyetim që t'shohim çka po del, 100 vjetori...

Erëmirë Krasniqi: Çka bojshit, a shkrujshit, a shpërndajshit parulla mandej në këto manifestime?

Zymer Neziri: Në vitet '70, po. Edhe ka pasur shkrime, ka pasur edhe parulla, ka pasur edhe revista ilegale pra dhe '70 ishte shumë i begatë. Dhe vërtet ka dalë një prej hallkave më të fuqishme të ndërtimit të historisë së re të shqiptarve në 100 vjet robëri për t'dalë nga robëria. Pra ka qenë ni nje e madhe, e fortë, e fuqishme, dhe që i ka kaluar nashta edhe shumë përpjekje të tjera të mahershme të një pjekurie politike pra të klasës studentore, po edhe të rinisë shkollore, po edhe të bujqëve edhe traktoristëve, edhe të zejtarëve, edhe të arsimtarve dej në Univerzitet. Por prapë, në '81, kjo e fundit pra, kjo shtresa intelektuale ishte jo në nivelin e dëshiruar. Nuk ishte, domethanë shtresa e profesorëve t'mi që mu m'kishin dhanë dikur msim në vitin '81, nuk ishin në nivel të detyrës kombëtare, nuk ishin.

Erëmirë Krasniqi: Klasa politike ju kishte lënë vet?

Zymer Neziri: Ne, ne, klasa politike, klasa politike natyrisht ishte po e njëjta e viteve '60 pra, '68, që prapë nuk e kreu detyrën e vet. Pastaj, pastaj edhe u korit, sidomos me deklarime që nuk duhet të thuheshin të tilla dhe të deklaroheshin madje, madje as nën tyten e pushkës bie fjala. Nuk do duhet t'i thonin ato fjalë që u thanë për këtë rini bëhet fjala, për plehun e historisë e tjera tjera. Por mëgjithatë, '81, domethanë ishte përfundimi i ndarjes me Jugosllavinë. Ishte një përfundim i ndarjes. Domethanë, nuk ka jetë me Jugosllavinë ma. Dhe natyrisht pati edhe arrestime. Ne na arrestuan, ne të tjerët që ishim në shënjestër pra, na arrestuan rreth dy qind sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës pra, Ministrisë së Brendshme.

Ajo kohë quhet koha e izolimit. Në burgun e Prishtinës ku kam qëndruar rreth pesë javë, pastaj në burgun e Mitrovicës dhe ishin vite të rënda, po vite të krenarisë. Unë mendoj se krenari kombëtare kurrë ma t'madhe shqiptarët nuk kanë pasë deri në luftën e fundit, sesa bie fjala në vitin e madh '81, që ka qenë ni pranverë shumë e përgjakshme, një prej pranverave më të përgjakshme pra të popullit shqiptar.

Dhe në vijim, në vijim Lëvizja Kombëtare, Lëvizja Kombëtare paguan shumë randë tagrin e përpjekjeve për liri, sepse libri që doli tash në Institutin e Historisë që është mirë ta keni, e ka titullin domethanë janë të burgosurit politik në këtë periudhë për t'cilën unë po flas, dhe ka 666 shekuj burg politik e 72 vjet, e 15 ditë. Kjo është një prej shifrave më marramendëse për botën politike, diplomatike të jashtme që jeton në Prishtinë dhe nuk e dinë këtë fakt. Dhe do duhej ta dini dhe do duhej secili ta ketë, bie fjala në zyren e vet një libër të tillë. 660 vjet... eh, gjashtë shekuj. Pra vetëm kjo periudhë e pas Luftës së Dytë Botërore, pa e llogaritur periudhën tjetër ndërmjet dy luftërave botërore, dhe periudhën tjetër para Luftës së Parë Botërore. Domethanë aq shumë ka paguar populli shqipëtar, pra një taksë, një tagër të cilin në përmasa evropiane dhe mund t'them edhe botërore sigurisht nuk e ka paguar askush.

Ata vetë kanë pranuar se janë mbi ni gjysë milioni njerëz, domethanë që janë në listat e zeza. Dhe kanë kaluar nëpër atë proces me ni gjysë milioni njerëz, domethanë rreth 500,000-600,000 njerëz. Mund t'a merrni me mend se po aq kanë qenë edhe fmi, kanë qenë edhe gra që s'kanë zhvilluar aktivitet politik po e donin, bie fjala, aktivitetin politik dhe t'mirën e lirisë së Shqipnisë, dhe shqiptarve dhe t'bashkimit. Po, domethanë, ni diçka që nuk mund t'merret me mend. Shërbimi jugollav natyrisht ka

qenë shumë i fortë, jo vetëm armata, po ka qenë edhe shërbimi i sigurimit, sepse kta bënë pjesë ndër katër deri pesë njësitë ma të mëdha të Evropës në kohën e vet, po do më thanë ishin të pajisur, të përgatitur. Dhe shih tash, me një makineri të përmasave të tilla, rinia shqiptare durë-thatë, rinia studentore, rinia shkollore dhe vet ky popull përballet me ta. Përballet guximshëm edhe nuk ndalet. Një demonstratë dhe tjetra, një dhe tjetra, një dhe tjetra. Dhe kështu kanë vazhduar vitet '80 në gjendje shumë të randë deri në vitin, deri në vitin '89.

Në vitin '89 ndodhë një përmbysje politike pra, e Serbisë, dhe Kosovës i hiqet edhe pak ajo autonomi që e kishte, natyrisht nga Millosheviqi. E pastaj aty nuk kanë të ndalur protestat, demonstratat, protesta, demonstrata, dhe natyrisht fillojnë edhe grupet e para të armatosura të organizuara në Kosovë. Edhe në Pejë me rrethinë, në bjeshkët e Rugovës, në rrafsh të Dukagjinit, në Drenicë pra, në Llaushë, në rrafsh të Kosovës, në Llap, në Gallap, dhe kështu kudo. Pra i kemi fillet e para të organizimit ushtarak pra të kundërvënies, kundërvënies që i thonë me pushkë të asaj Jugosllavie pra që përfaqësonte Serbia.

Erëmirë Krasniqi: A po flisni për kohnat e Rankovicit?

Zymer Neziri: Jo, po flas menjëherë pas '81, domethanë mbaroi me '89, u hoq autonomia dhe filluan, filluan luftat në Jugosllavi pra. Filluan luftat në Jugosllavi me Slloveninë së pari dhe këtu në Kosovë domethanë, dhe këtu i kishim grupet e para të armatosura të organizimit pra...të gjitha lidhen domethanë me procesin '81 i cili nuk përfundoi, por vazhdoi. Vazhdoi dhe ai vazhdim domethanë nxorri edhe njësitë e para të armatosura në fillim të vitit '90 kur bahej luftë në, bie fjala Kroaci, bahej luftë në Bosnje dhe ne i kishim njësitë e para, por nuk ishin të ngritura njësitë, në njësi të mëdha siç janë ngritur më vonë brigadat pra rreth 33 sosh që kanë vepruar në viset tona, për shkak se ishte një fillim i fillimeve dhe ishte një mundësi më modeste se me të tjerët që ishin bërë gati për luftë.

Erëmirë Krasniqi: A ishin grupet ilegale që i organizojshin?

Zymer Neziri: Natyrisht, grupet ilegale të organizuara këtu. LPK-ja printe, po printe LPK-ja pastaj nga krahu tjetër që u nda LKÇK-ja. Dhe ka pasur grupe të pavarura që kanë vepruar pra, se nuk ka rrugë tjetër për shqiptarët, por vetëm përpjekja e armatosur, se janë provuar të gjitha dhe të gjitha ranë në ujë edhe me Jugosllavinë edhe me Evropën. Vetëm kjo kishe mbetur pa u provuar dhe duhet të provohet, dhe deshtëm e s'deshtëm ne këtë, do ta provojmë. Sepse kishte shumë njerëz në kohën kur pajtimet e gjaqeve, nuk na ra t'i përmendim, që ishin në fillim të kësaj periudhe pra, dhe domethanë ky popull vërtetë kishte një, një krenari, një dinjitet, prapë po them të përmasave epike n'atë tubimin bie fjala të 1 majit, 1990, tubohen pesë qind mijë njerëz për tu pajtuar me njëri-tjetrin. Që nesër në luftë ta kenë shpinën, si me thanë, të sigurtë nga tjetri, vërtetë shkojnë në luftë si vllazër, të një gjaku, të një gjuhe...po, dhe ajo ndodhi po...

Mirëpo... mirëpo, mirëpo, mirëpo më pastaj tash kjo pjesa pacifiste e kreu punën e vet dhe nuk e kreu mirë, natyrisht e kreu edhe me dame, sepse (kollitet), sepse nuk kishe vend për te sigurisht edhe komentet, komentet pastaj ndikuan shumë keq dhe në kohën kur përfundoi, përfunduan luftërat e jugosllavëve me njëri-tjetrin. Domethanë, në vitin '95, ne ishim, ishim domethanë para gojës së ujkut dhe nuk e dinim a jemi ne Prishtina pra, a Shkupi apo Shkupi e Prishtina bashkarisht. Dhe doli e dhëna

që aso kohe na mrrijti këtu në Prishtinë në këtë sallën e poshtme ku vepronte, Forumi i Intelktualëve Shqiptarë, se Shkupi ashtë i paprekshëm, shkaku se armata bullgare ashtë e zonja t'mbroj Shkupin, të mbrojtë vetën dhe Serbia nuk e ka guximin pra që të kacafytet me armatën bullgare. Dhe ashtu edhe ndodhi, Shkupi mbeti pa asnjë fishek i ndezur e Prishtina... vaj halli për te, prandaj ne ishim keq, armata shqiptare u shkatërrua n'emër të demokracisë pra ishte gabimi më i madh në historinë e shqiptarëve, t'shkatërrohet armata.

E shkatërruan armatën me 25 divizione, në Tiranë po, e shkatërruan armatën, e shpërndanë i lanë vetëm shtatë divizione, prej tyre dy i lanë në emërgjencë Kuksin edhe Gjirokastrën, dhe ç'të bënte Kuksi gjenerali Kudus Lama? Ni...ni...ni njeri i energjive t'jashtëzakonshme ushtarake, njrëzore dhe intelektuale t'mbronte një Shqipëri, një shtet me një divizion që mund t'mbrohet vetëm një Kukës me rrethinë, por jo t'mbrohet edhe Kosova, sado që aktiviteti i tij dhe kontributi i tij është jashtëzakonisht i madh. Shqipëria ra në dy divizione saktësisht, veriu i lartë, kacafytja me Serbinë dhe Malin e Zi ra në një divizion.

Pra ne i dinim mundësitë tona, kanë qenë mundësi shumë të vogla, shumë modeste. Të holla shqiptarët kishin grumbulluar pak për luftën edhe “Tre përqindëshi” edhe “Vendlindja Thërret” edhe fondet e tjera e “Ahenit” e të tjera. Nuk dua t'i përmend t'gjitha, domethanë kishim tepër pak para, tepër pak, n'krahësim bie fjala me ato që i grumbulluan kroatët ndërtuan një armatë moderne thirren ekspertët e mirë, dhe ma t'mirët që ishin nga Amerika, Kanadaja dhe ndërtuan një armatë dhe çliruan krahinën që duhej çliruar pra, krahinën e Kninit dhe aty për njëzet e katër orë valoj Shahovnica, flamuri kroat.

Këtë ne nuk ishim n'gjendje ta bënim, sepse nuk kishim para. Fatkeqësisht një pjesë e atyre të hollave nuk janë përdorur si duhet dhe tash po dalin bishta, po dalin fjalë që sigurisht kanë edhe një arsye pse dalin si të tilla, sepse këtu në front ka qenë shumë vështirë. Ka qenë tepër vështirë edhe për armatim është dashur, bie fjala, të pushohet pak deri sa tyta... bie fjala të...të...të si me thanë, t'i kaloj pak ai zjarrmi i madh, si me thanë, dhe të, të ftofet pak, domethanë këtu në kushte shumë t'vështira u banë organizimet e luftës. Dhe natyrisht ajo luftë doli, doli lufta e parë, domethanë që e fituam. Sigurisht me Bashkësinë Ndërkombtare në krye, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por megjithatë edhe kjo ka qenë, ka qenë domethanë ka qenë një përpjekje prapë po thom e përmasave që nuk ka munduar askushi t'i marrë me mend se duhej të bajmë luftë me Serbinë, por me kushtet që i kishim ne, Serbia ende ka t'holla rezervë. Tash flitet për Qipron, për rreth një miliard, unë kam qenë vetë dëshmitarë kur Serbia ka plaçkitë Kosovën, ka plaçkitë fondet e mëdha, fondet bankare, fondin e Trepçës, fondin e... e këtu Kastriotit pra të Obiliqit, ka plaçkitur fonde nga llogaritë dhe në fund plaçkiti vet fondin e federatës. Dhe thanë, “Jo, të gjitha paskan marrë!” Dhe tha, “Hajde ta de... devaluojmë dinarin për dyzet përqind” dhe asaj i ra, domethanë Serbisë t'i falen rreth dyzet përqind të mjeteve, a i kishte plaçkitur miliardat. Pra Serbia është përgaditur për luftë dhe thonë sasia e përgaditjes së saj kalonte shkallën rreth 50 miliard dollarë. Po edhe të tjerët...

Erëmirë Krasniqi: A ishit të pregaditur për luftë?

Zymer Neziri: Po ne nuk kishim, domethanë ne nuk kishim, ne ishim ata qe prisnim domethanë prisnim thonë, “Si dhija te kasapi” dhe na zuni tepër keq. Shteti kombëtar i yni, një qind vjet që bënë ekzitencë domethanë shkatërroj armatën, shkatërroj të gjitha, mas mrami shkatrrunë edhe hekurudhat, kanë ngarkuar hekurudhat, kamionat dhe i kanë shitur (buzëqesh) në Mal të Zi, në Nikshiq, po, shkatërruan bibliotekat...

Erëmirë Krasniqi: A mundemi m’u ngadalësu pak, mu kthy te ‘90-tat ku, ku ja nisë Pajtimi, me na përshkru pak ma n’detaj përfshirjen e juv n’atë Lëvizje edhe rolin e juv gjatë atij organizimi, nëse bon?

Zymer Neziri: Po, Lëvizja e Pajtitit erdhi si një përgjigje ndaj krejt atij represioni të madh që bëhej mbi rininë shqiptare, mbi popullin shqiptar. Ishte një ide gjeniale e grupit të t’rinjëve pra, të Havë Shals dhe Mirevte Dreshajt po edhe të Brahim Dreshajt, të Hetem Çekut, të Adem Grabovcit, Lulzim Hetemajt që po sa dolën nga burgu thanë, “Kta 32 që na i vranë në demonstrata, na i hapën 32 varre, hajde t’provojmë t’i falim 32 gjaqe dhe t’mos i hapim edhe 32 të reja me dorë tonë, kta na i vrau Serbia, na tash t’mos e vrasim njëri tjetrin.” Domethanë kjo ka qenë moto dhe simbolika e fillimit të pajtitit të gjaqeve në datën 1 Shkurt, 1990.

Unë mendoj se ka qenë thashë, gjeniale, një ide të cilën sigurisht do ta realizonte rinia shqiptare në ato rrethana ndoshta ma ndryshe, po ky ishte ai filimi. Prandaj t’gjithë ata që e fillojnë u mbetet nderi i historisë, dhe kta e kanë nderin e historisë, fillimin pra, grupi, bërthama. Kjo bërthamë pastaj është zgjeruar dej në shkallën tetë qind aktivistë, pra kanë marrë pjesë në Pajtimin e Gjaqeve. Nga liqeni i Shkodrës, pra në viset tona, në Malin e Zi edhe deri te liqeni i Ohrit, aq kemi shënime, mund t’kenë qenë edhe ma shumë sigurisht, po dashamirës të Lëvizjes kanë qenë më dhjetra mijra sigurisht edhe me miliona aq sa ishim rreth tre milion nën Jugosllavinë.

Kjo ndërtesë ku jemi sot, pra Instituti Albanologjik ishte bërthamë edhe teknike edhe shpirtërore edhe bërthamë e aktiviteteve që zhvilloheshin në terren në të gjitha viset. Pse? Pse këtu vepronte profesori Anton, këtu vepronte profesori Zeqë, Zekerija Cana, këtu vepronin edhe të tjerët dhe mund t’them se gati të gjithë punonjësit e Institutit Albanologjik të Prishtinës kanë qenë të përfshirë në Lëvizjen e Pajtitit të Gjaqeve. Këtu, në këtë Institut u formua edhe kartoteka e parë e Lëvizjes e Pajtitit të Gjaqeve që është fat i mirë. Sot ajo kartotekë është shnëdruar në libër në rrethana shumë të vështira, në kohë të luftës doli nga shtypi dhe aty kemi të dhëna përafërsisht rreth pesë mijë familje, saktësisht për dy mijë e pesë qind falës dhe po aq familje të falura ku përfshihen gjaqet, ngatërresat dhe natyrisht përfshihen edhe plagët.

Lëvizja ka qenë e domosdoshme, domethanë ka qenë domosdoshmëri historike po edhe një akt historik sepse, sepse aty u pa edhe shpirti, si me thanë liridashës i shqiptarëve që lirinë ta fitojnë nga vetëvetja ta shlirojnë tjetrin edhe pse duhej falur një gjak duhej falur dy duhej falur tre. Çelësi i suksesit të Lëvizjes sigurisht ka qenë mënyra se si ju kemi afëruar problemit, qasja ndaj problemit si po thuhet tash. Cila ishte ajo? Nuk ishte tradicionalja si deri atëherë që e kan zbatuar të tjerët para nesh, breza të tjerë pra deri te brezi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit që kishte pasë shumë kështu një këshill të pajtitit dhe kanë vepruar këshilla edhe të tjerë edhe ma herët edhe ma vonë.

Po une menoj se ky çelësi i suksesit ka qenë vetë mënyra se si ju ke afruar problemit, pra ti nuk e ke trajtuar problemin se, “të vrau, a ka pas drejtë me të vra, a ka bo gabim që të ka vra e tjera e tjera, duhet bie fjala mu la dami, gjaku e tjera e tjera.” Domethanë, këto nuk janë marrë parasysh. Falja bahet vllazërore, falja bahet në emën të popullit, falja bahet në emën të rinisë, falja bahet në emën të flamurit, sheh sa bukur? Dhe këto në unitet kanë jetuar mirë e aq bukur sa vërtetë në të gjitha cepet ku jetonin shqiptarët në ish-Jugosllavi pra, në Mal të zi, në atë pjesën shqiptare në Serbi, në Maqedoni dhe këtu në Kosovë. Ka qenë shumë funksionale kjo, në emër të popullit të rinisë edhe të flamurit (buzëqesh). Po, dhe kur përmendej flamuri atëherë kishte duartrokitje, ishin duartrokitje të gjata, jashtëzakonisht të gjata, ishin marramendëse. Njerëzit çoheshin në këmbë dhe këndoheshin kangë atdhetare dhe në këto raste sigurisht edhe familjet që s’ishin t’pranishme aty edhe atyre u ligëz zemra. Por në terren për të përgaditur një rast për takime të tilla nuk ka qenë lehtë.

Erëmirë Krasniqi: Ju keni qenë ndërmjetësues. A mundeni me na përshkru pak përvojën?

Zymer Neziri: Po, unë kam pasur fatin të jem në shumë raste domethanë të kohës që kam kaluar në Lëvizjen e Pajtitimit, kam punuar drejtëpërdrejt në proces kam qenë. Unë pa të keq e përmenda rastin 63, një përpjekje që e bëmë 63 herë me tri ekipe një në Rugovë, një në Pejë, një në Prishtinë dhe një ekip tjetër që na ndihmonte herë pas here në Zvicër. Natyrisht rasti u fal mirëpo është dashur të investosh shumë, ka qenë një rast tjetër prapë, një rast tjetër prapë i ngjajshëm me këtë rast sa do që ka qenë një rast gruaje kur ajo vret domethanë mikun për shkak të vajzës që bënë domethanë vetëvrasje apo djali i saj. Vërtetë dhe edhe ka qenë një prej rasteve shumë të rënda, por ka pasur shumë raste të tjera që unë ato nuk i di, por po flas për raste që i di nuk kam pasur raste të lehta.

Ka pasur raste ku shteti drejtëpërdrejtë e ka mbajtur situatën në dorë dhe ti, domethanë ke bërë përpjekje gjatë një dite me ekipe ke investuar me qindra orë dhe në fund në mëngjes nuk ke parë as temel me sy, çka do të thotë nuk kanë lanë as gurë në temel. Rasti është ky bje fjala konkret, njeriu që duhej të vriste tjetrin të vetin për gjakmarrje nuk e vrau po vetëm e plagosi dhe pushteti e arreston, e burgos, e dënon. Dhe tash ata i kanë thanë, “Në qoftëse ti e fal gjakun, ti duhesh ta mash burgun dhe nëse e bënë burgun atëherë me siguri...” thotë, “do të kushtojë shumë”. Ose jau kallxon variantin tjetër që mund ta falësh dikur tjetër, por tash mos e fal domethënë nëse do t’i shpëtosh burgut për një plagë bie fjala që ia kish dhanë familjes, familjes së hasmit dhe që edhe ky rast bie fjala ishte prej rasteve shumë të rënda.

Pushteti pastaj e bënte pengesën tjetër, dilte në rrugë, “Ndal, dokumentet jepi, ku po shkon?” “Këtu.” “Pse po shkon?” “Për këtë.” “S’ke me shku. Kthehu!” Janë tubuar, bie fjala, janë bërë gati që të tubohen i kanë ndaluar që të shkojnë në tubim dhe ka pasur shumë raste dhe rrethana kur nuk i kanë lejuar tubimet ose kanë pasur shumë raste kur kanë ndërhyrë në tubime, por të shumtën e herave i kanë ndaluar tubimet. Sidomos në fazën e parë të fillimit, pra në muajin mars 1990 flas për rastin konkret, bien fjala, për tubimin e Rugovës në katunin Shtupeq me datën 24 mars atje...

Erëmirë Krasniqi: Si e prezantojshit ju...

Zymer Neziri: Po atje...

Erëmirë Krasniqi: Qet' qasjen e re të pajtimit, meqenëse ka pasur përvoja edhe të tjera që s'kanë qenë shumë efektive.

Zymer Neziri: E qasja e re, po qasja e re unë po them çka ka qenë sigurisht qasja... si të themi sigurisht ma vendimmarrje ma të randsishme nuk ka vepruar asniherë asni grup para nesh në histori sesa kësaj here pse domethanë asgjë nuk është marrë parasysh, u marrë parasysh vetëm gjaku që nuk duhet të derdhet gjak për ni gjak, kaq. E këto bindje, këto bindje sigurisht kanë qenë ma të lehta sado që ata janë arsyetuar më ka vra keq e tjera, e tjera. Më ka lanë keq, e mi ka lane fminë jetima e plot, plot do tjera. Arsyetime që ishin të gjitha me vend por kjo jau mbyllte derën të gjithave.

Mbyllej dera domethanë se gjaku duhet të falet dhe për atë gjak nuk duhet derdhet gjak sepse e kemi tjetrin mbi krye që po e derdh gjakun tonë dhe të mos jemi ata që ne e derdhim gjakun barabarë me gjakun që e derdh Serbia mbi ne dhe nga gjaku ynë, dhe kjo ishte ajo sigurisht qe njerëzit edhe i nxiste dhe përveç asaj i bindte shumë ma lehtë, sesa të fillosh të bësh, bie fjala, matje. Kjo del këtu, kjo s'del, kjo barazohet me kte, kjo s'barazohet. Dhe në fund merrte edhe kohë shumë si proces dhe përveç asaj ka mund edhe të mos sjell rezultate. Prandaj në vitin 1990 nuk ka pasur gjakmarrje, në vitin 1991 (buzëqesh) nuk ka pasur gjakmarrje, në vitin 1992 nuk ka pasur gjakmarrje, nuk ka pasur. Por nuk janë pajtuar të gjitha gjaqet natyrisht disa prej tyre pastaj kanë vazhduar edhe pas luftës me pasoja.

Disa raste ka pasur të keqpërdorimit sigurisht të Lëvizjes, se Lëvizja ka mbajtur tri kuvende, kuvendi i fundit është mbajtur këtu në Institut me datën, 17 mars, 1992, kur edhe mbyllet Kuvendi i Pajtimit të Gjaqeve. Sepse të them se filloj edhe të keqpërdoret, kishte të tillë që s'e kishin gajlen e pajtimit shqiptarëve hiç, kishte të tillë s'e kishin gajlen e robërisë së shqiptarëve. Po dhe me arrogancën që e kishin, sidomos këtë arrogancën orale, po gojore, po ka ndodh t'i thotë njeriut, "Tap ni shuplakë, t'i msheli dy birat e veshëve. Shkojmë te Antoni dhe na pajton Antoni u kry puna." Po, domethanë keqpërdorim (kollitet). Por megjithatë kjo... përfundoi kjo fazë.... kërkoj falje, e mbyllni pak.

Noar Sahiti: E prejme masanej s'osht' problem.

Zymer Neziri: E ndërprejmë masanej dhe... {pinë ujë}. Pra çelësi i suksesit ishte te vetë metoda pra që është zbatuar, çelësi i suksesit ishte te vetë qasja e problemit dhe çelësi i suksesit ishte vullneti i atyre vajzave dhe djemëve që ishin mbi tetë qind. Çelësi, sukseksi ishte angazhimi i këtij Instituti dhe i profesorëve të të gjithave fakulteteve po dhe i shkollave të mesme dhe fillore. Çelësi i suksesit ishte dhe vet familja që falte gjak, që vinte me ne dhe e shihnin të tjerët. Dhe rasti konkret Marian Demaj, tash rektor, po, atij iu kishin vra në familje tre vllazër, dhe Marian Demaj bahet burrë dhe në emër të familjes prapë, në emër të flamurit, të rinisë edhe të popullit fal gjakun e parë, gjakun e dytë dhe gjakun e tretë. Dhe merrnim Marianin, dhe Mariani pastaj u ba një prej veprimtarëve ma të mire të Lëvizjes. Dhe kështu kemi vepruar saktësisht deri në tri ditë para se të mbahet kuvendi përfundimtar i Lëvizjes së Pajtimit deri më datën 14 maj.

Por kur shkuam në familje në rrethin e Gjakovës ku supozonim se në qoftëse do ta lihnim rastin dhe do të falet rasti, atëhere kishte mundësi edhe në katër, pesë raste të tjera të kishim sukses sepse ishin të ndërlidhuara, dhe thamë, “Po e sjellim edhe një rezultat të ri në përfundimin e Lëvizjës”, dhe vajtëm atje. Dhe natyrisht pastaj patëm probleme edhe me policinë një orë, e dy, e tri, e shtatë, tetë orë patëm probleme me ta te ura e Rakovinës, te arrestimi, te, në Gjakovë atje në gjykatë, bie fjala për kontrollim e një kasete që kishte kangë atdhetare dhe pastaj gjyqtari konstanton se nuk osht’ noj kangë e ndaluar ajo. Por megjithatë, domethanë kishim, kishim probleme deri në çastin e fundit me policinë, me policinë Jugosllave në këtë rast serbët domethanë këto i banin. Dhe prapë kthehem te ky brez, unë them se vërtetë kjo ka qenë një luftë e madhe me vetëveten, ka qenë një luftë e madhe me traditën, ka qenë një luftë e madhe me historinë e kulturës dhe tekno-kulturës së shqiptarëve. Pjesa e Pajtimit të Gjaqeve, të pajtohesh me vetëveten dhe pajtimi me vetëveten nuk ka qenë i lehtë, ka qenë shumë i vështirë, por prapë po them merita mbetet me ata që kanë falë dhe merita mbetet te këta që kanë ecë që familjet të afrohen dhe të pajtohen.

Pjesa e Tretë

Zymer Neziri: Po grupi që veproi në Rugovë, ishte një grup që punoi shumë, dhe pati rezultate, pothuajse përfundimtare për të gjitha rastet. Rastet nuk ishin shumë, po ishte një fatmirësi sepse në vitin 1970, në Rugovë u organizua Besëlidhja, dhe në atë Besëlidhje procesi i hakmarrjes dhe i vrasjeve të themi u nal. Kjo ndikoi shumë që në Rugovë të mos ketë shumë raste, t’ketë pak raste. Ky ishte rasti më i veçantë që ndodhi në viset shqiptare pra, Besëlidhja e Rugovës, bashkë me një besëlidhje tjetër po në atë vit që u organizua në Malësi të Madhe, në pjesën që mbeti në Malin e Zi, pra me seli në Tuz. Këto dy besëlidhje natyrisht kanë ndihmuar shumë.

Kthehemi te rasti i Rugovës. Në Rugovë pra, ekipi që punoi në krye me Isë Nikçin, profesor i Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, po aty ishte edhe Sali Lajqi, që pastaj bëhet komandant i Brigadës 136 Rugova, mandej Zyrafete Muriqi, e kështu edhe disa të tjerë që kemi vepruar aty. Tubimin menduam ta bëjmë sa ma herët për shkak se kishte nevojë që terreni ta ndjej veten mirë, domethanë, t’mos thuhet, “Po i falim gjaqet dhe s’po merret vesh kurgjo”, sepse rrethimi policor ishte shumë i ashpër. Dhe në rrethime të tilla policore lëvizjet e njerzve ishin të pakta madje edhe mungonin, dhe ne thamë, “Megjithatë, po e bajmë”, dhe e qitëm fjalën që tubimi do t’mbahet.

Mirëpo, çka ndodhi? Policia, si thonë në shtatë rrahë hyrjet në Pejë i kontrolloi kështu që shumë njerëz nuk dolën atje. Disa hoqën dorë disa të tjerë u detyruan të heqin dorë. Por megjithatë, ai tubim tuboi rreth shtatë mijë njerëz dhe kjo ishte ajo, si me thanë thyrja e parë e policisë Jugosllave në Pejë me rrethinë, se tubimet megjithatë mbaheshin. Domethanë osht’ e pamundun t’i ndalosh. Ata qëllimin e kishin t’ndalojnë këtë tubim. Qëllimin e kishin t’i friksojnë njerëzit mos t’dalin dhe e dyta t’i ndalojnë që t’mos shkojnë atje. Osht’ rasti shumë interesant i kamerës bie fjala, se si e kemi qitur kamerën atje. Të gjithë dështuan dhe në fund një nga ata, Qerim kështu quhet, jeton tash në Zvicër, Qerim Sheli tha, “Unë e qes kamerën.” “Qysh e qet?” Tha, “Kollaj”. Një çikë aty e takoj në rrugë të cilën nuk e njihje e

kapi për krahi, “Nëse thojnë policia, çka keni ju dytë, thuni jemi t’fejum”. Ata nuk njiheshin fare, jemi t’fejum kamerën në krah, “Na nuk po dalim nalt atje n’Shtupec, por po dalim me shetit”. Dhe u nisën në pjesën e djathtë t’atyre kodrinave dhe natyrisht për t’zbritun pastaj ma poshtë dhe për tu bashkuar me ne. Dhe kshtu edhe ndodhi, kshtu e kemi qit kamerën, domethanë në Shtupec, njërën nga kamerat.

Tubimi i Shtupecit në krahasim me tubimet e tjera të cilat kishin me dhjetra mijëra njerëz, njiqind mijë, dyqind mijë deri në pesë qind mijë nuk ishte i madh, por e madhja e madhja domethanë e këtij tubimi ishte se, ishte një thyrje e përpjekjeve të policisë Jugosllave që t’i ndaloj tubimet. Një thyrje e tyre dhe njëheri ishte fitorja e jona e madhe për të gjithë veprimtarët në terren dhe njëheri fitore e madhe për t’gjithë ata që kishin falur dhe kishin dëshirë që falja të bahej në mënyrë solemne në atë tubim. Aty ka qenë profesori Anton në këtë tubim, ka marrë pjesë, ka folur, ka përshëndetur. Ka qenë n’këtë tubim edhe profesori Zekerija Cana, që ishte dora e djathtë e profesorit Anton në terren. Por kanë qenë edhe të tjerë profesorë universiteti, pra arsimtarë, nxanës, studentë, lektorë, bujq dhe të tjerë. Dhe këto tubime pa pikë dyshimi i kanë dhanë fuqi të madhe Lëvizjes së Pajtitimit, sepse vinin duke e nxitur, si me thanë, Lëvizjen që t’i organizoj këto gati në të gjitha rajonet. Dhe ato u organizuan dhe patën sukses.

Po, detaji që zakonisht nuk thuhet nuk përmendet fare e që çon peshë shumë, sidomos sot kur jeta po materializohet, kur secili njeri kqyr që çdo gja ta barazoj bie fjala me euron, apo jo, me paranë. Asokohe, asni vajzë, asni djalë nuk ka marrë asni shpërblim. Madje herë- herë nuk kanë pasur para as për t’blerë ujë, si thonë, po osht’ dashur t’pritur që t’shkojnë te ni burim, bie fjala te një krua që t’pijnë ujë. Nuk kanë pasur para, bie fjala as për bukë. Shumë herë bukën e kemi ngrënë në dorë, bie fjala, pak bukë edhe pak djathë. Dhe problemi më i madh ka qenë i lëvizjes me makina, benzina ishte e shtrejtë. Po ishte, domethanë ni knaqsi e madhe dikush për t’i dhënë dhetë litra benzinë, bie fjala. Por, edhe kjo pjesë qëndron në shpirtin e asaj që quhet vërtetë mobilitet i madh human së pari, pastaj edhe kombëtar i asaj rinie. Po, nuk ka kqyr kush paranë për 26-27 muaj sa ka zgjatur Lëvizja. Jo, dhe sigurisht kjo e ka nxjerr shumë të pastër para historisë si Lëvizje moderne, si Lëvizje humane, si Lëvizje njerëzore por edhe si Lëvizje kombëtare pse jo.

Erëmirë Krasniqi: Sa raste jon pajtu në Shtupec dhe çfarë, çfarë natyre t’ngatresave kanë qenë ato?

Zymer Neziri: Po, ngatresat ishin si të viseve të tjera. Disa ishin edhe ngatresat natyrisht të shkallës së asaj që quhet se nuk do t’duhej t’ndodhte ashtu, po çasti kur gjaku nxehet, si thuhet, ndodhin edhe t’papuraturat. Kishte dhe raste, domethanë të ngatresave ndër familjare, të rrethit të gjerë, kishte edhe raste të gjaqeve bie fjala të, që quheshin atëhere gjaqe, falje e gjaqeve në komunikacion. Domethanë nga më të ndryshmet, por ajo kryesorja ishte se ekipi është pritur mirë, është pritur mirë në secilen familje, është pritur jashtëzakonisht mirë dhe ekipi me të vërtetë ka qenë i pa, si me thanë, i palodhshem dhe ka punuar shumë. Dhe pastaj mbasi kanë mbaruar punë me rajonin e vet, ai ekip ka punuar në Podgurë, domethanë në katunet e rrethit të Istogut. Ka punuar në lugje që pjesërisht i takojnë edhe Klinës, tash pra në Lugjet e Pejës. Ka punuar në Rekë, dej në Rekë të Keqe, po kanë

punuar edhe në rajonet e tjera, pra ku kishte nevojë. Dhe kësi soji veprohej pra me ekipet, kur ekipet mbaronin punë në rajonin e vet kalojnë në rajonin tjetër dhe baheshin ndihmës pra të pajtimit.

Erëmirë Krasniqi: A ju shërbjeshin juve studimet e juaja për me, me pajtu njerz, po mendoj për me njoft rastin ma mirë?

Zymer Neziri: T'drejtën t'ju them edhe ata që dinin, sa dinte një profesor aso kohe, edhe ata që dinin sa din një student gati thuaj bëheshin të barabartë. Po marr rastin...

Erëmirë Krasniqi: Studime mbi regjione të caktume mendova.

Zymer Neziri: Po kto, po kto, natyrisht ne na hynin në punë. Por te rastet konkrete pastaj kur vinte puna, të themi te ajo që quhet, që quhet.. investim, investim moral, investim njerëzor, investim kombëtar për pajtim, atëherë aty, aty vinte zëri i brezit të ri, natyrisht ka qenë shumë shumë ma efikas. Bie fjala rasti, bie fjala i Havës, i Havë Shalës, rasti i Myrvete Dreshaj, por edhe i të tjerave si thashë, Zyrafete Muriqit dhe i shumë, shumë vajzave të tjera që kanë vepruar në Lëvizje. Ka qenë shumë me interes një vajzë t'flas në odë të burrave, t'flas me burra, për punë të burrave, për gjaqet që i kanë bërë burrat pra, edhe natyrisht edhe për shkak të grave. Pra zëri i tyre vërtetë ka qenë një zë që ka çuar peshë shumë. Edhe në tubime, në odë po them me burra, edhe në tubime ku kishte me dhjetra mija njerëz, por edhe i djemve. Prandaj po them, zëri i rinisë unë mendoj se ka qenë freskia më e madhe në Lëvizjen e Pajtimit, edhe vet si moshë, por edhe zëri i tyre, fjala e tyre. Natyrisht të gjitha t'mbështetura në rrafshin kombëtar dhe social. Duhet të pajtohem sepse mund të jetojmë ma mirë edhe duhet të pajtohem sepse e kemi shumë ma lehtë që të shlirohemi domethanë nga, nga pushtuesi dhe...

Erëmirë Krasniqi: A është inkuraju pjesëmarrja e grave në Lëvizje, apo ka qenë në mënyrë spontane?

Zymer Neziri: Jo është in... ka qenë, ka pasur edhe spontanitet edhe jo spontanitet, po them në grupin e t'rive. Unë nuk e di që kanë mbizotruar djemt, ka pasur raste kur kanë mbizotruar vajzat, domethanë grupi i vajzave ka qenë grup shumë aktiv. Natyrisht kanë qenë grupe mikste pra, të përziera bashkarisht, por grupi i gjinisë, domethanë i gjinisë femërore sidomos në moshat e reja ka qenë shumë, shumë i pashëm, i dukshëm (buzëqesh) dhe në atë kuptim për ka shumësia. Djemve, djemve nëse s'ia ka kaluar është barazuar me ta. Por edhe i grave të tjera arsimitare pra, i grave të tjera arsimitare që kanë marrë pjesë në Lëvizje, studjuese, profesoresha pra, natyrisht ky ka qenë grup ma i vogël. Po grupi i studenteve ka qenë grup shumë i madh, ka qenë shumë i madh, natyrisht po them nuk është dalluar fare grupi i djemve se osh' ma i madh, e kto janë ma pak. Përkundrazi kanë qenë të barabartë. Dhe fjala po them, prapë ka çuar peshë shumë.

Unë kur kam qenë në tubime, bie fjala kur ka folur dikush nga vajzat, po e zamë studente, e kom ditur se ato bajnë punë shumë ma shumë se dy djem kur flasin. Po se ata i kanë dëgjuar me shumë vëmendje dhe i kanë marrë arsyetimet, vërtetë i kanë marrë me shumë zemër, se në qofse nuk ia ligë zemrën pak nga pak dhe shpirtin ta prekësh n'tel dikun e kishte vshtirë, thotë "Po more, hajt p'e kryjmë këtë punë" (buzëqesh). Ka pasur raste shkoje një herë, e dy herë, tri herë edhe ktheheshe kot.

Domethanë rasti duhej ligur si i thojnë në atë kuptim, t'liget shpirti i tina në atë kuptim, dhe t'madhështohet me anën tjetër që thotë, "Po, po, e falim gjakun".

Pra roli, roli i femnave në Lëvizjen e Pajtit me t'vërtetë ka qenë në shkallën ma t'largë të historisë, po them kështu sepse femnat kanë marrë pjesë në Pajtim të Gjaqeve edhe ma herët, por ma pak meqenëse s'kanë pasur drejtë t'marrin pjesë në tubim të burrave. Siç e dijmë edhe Lidhjen e Prizrenit edhe gjatë Rilindjes edhe pas saj, edhe ma herët deri te tubimet e hershme domethanë të para gjashtëqind vjetve, po edhe ma herët, por sidomos këto të kohës së Skënderbeut, bie fjala të përpjekjeve të tij për lirinë e Shqipërisë, femra qëndron e barabartë me burrin që nuk e kishe në Evropë. S'e kishe në Evropë, kishte të drejtën e fjalës në burra qoftë edhe bareshë jo nga familja princore, ajo po se po, po edhe baresha e kishe atë të drejtë, në qofëtse kishte dhunti nga natyra që kishte mend sa një burrë si thonë, madje edhe ua kalonte burrave.

Pra kjo traditë vazhdon në Lëvizjen e Pajtit tash domethanë në këtë fazën e fundit të pajtit në vitet '90, të shekullit që posa shkoi. Dhe unë po besoj se në të ardhmen e afërt do të bahët edhe një studim i veçantë për rolin e saj në Lëvizje të Pajtit, një rol që vërtetë çon peshë shumë edhe për historinë, për historinë domethanë edhe çon peshë shumë edhe për vet Evropën, Evropën, domethanë, dhe traditën, traditën evropiane të barazisë, barazisë gjinore.

Thash se studentët, arsimtarët dhe gratë pra që kanë Lëvizjen e Pajtit kanë qenë veprimtare, roli tyre thashë ka qenë vërtetë me peshë madje herë-herë edhe me peshë vendimtare. Por kjo që e keni dëgjuar pra që ka thanë profesori Anton, po kanë thanë edhe veprimtarë të tjerë është shumë e vërtetë, se vajzat, gratë pra, veprimtare të Lëvizjes së Pajtit kanë depertuar nëpër familje shumë ma lehtë, sidomos te bota femrore. Pra te nanat që kishin mbetur pa djal, te gratë që kishin mbetur pa burra, te vajzat që kishin mbetur pa vlla pra, kanë deportuar shumë ma lehtë. Shumë më lehtë kanë folur dhe puna në këtë rast domethanë ishte vërtetë shumë, shumë e madhe dhe kur familja domethanë bëhej gati për t'falur, natyrisht përpjekjet e para dhe rezultatet e para vinin pikërisht nga bota femrore. Dhe unë mendoj se ky rol pra, i dyfishtë ka qenë i veprimtareve, domethanë kanë kryer punën e dyfishtë sepse kanë depertuar edhe në familje. Edhe natyrisht në ato familje kur ka ardhë një "Po" nga nana bie fjala për djalin, ka ardh një "Po" nga motra për vllaun, ka ardh një "Po" bie fjala nga gruaja që ka mbetur pa burrë. Kjo ka qenë një "Po" e madhe, ka qenë një "Po" vendimtare pra që ai gjak të falet dhe t'mos kërkohet ma si gjak dhe ato dy familje të mos jenë ma familje në armiqësi, siç thuhet ndryshe të hasmuara.

Erëmirë Krasniqi: Gjatë viteve të Fushatës të Pajtit të Gjaqeve e përmendët që familjet iu kanë dhanë besë. A kishit mujt me na tregu rreth qasaj?

Zymer Neziri: Po rastet që nuk janë falur nuk kanë mbetur shumë. Ka rajone që nuk kanë mbetur fare, por ka rajone që kanë mbetur pa u falur. Por në ato raste, domethanë sa herë që kemi bërë përpjeke, një herë, dy herë dhe më shumë herë dhe nuk kemi pasur rezultate, por megjithatë rezultat ka qenë kjo që thoni ju, se n'ato familje na është thanë, "Hiç mos t'kanë gjalle, s'e kem menën me i vra dhe kanë

besë dhe nëse duhet u japim besë prapë.” Domethanë, “Në kohën e Lëvizjes së Pajtitimit ne nuk do t’ marrim hak.” Dhe osht’ e vërtetë e kanë mbajtur fjalën.

Unë nuk di një rast pra, në vitet ’90 pra, mbas fillimit të Aksionit për Pajtimin e Gjaqeve që pastaj shëndrrohet në Lëvizje pra, mas 1 shkurtit 1990 që t’ ketë dalë dikush dhe t’ ketë marrë hak. Nuk di, domethanë nuk ka pasur. Sado që unë duhej ta dija, profesori Anton, ekipi ynë këtu në Institut, meqenëse edhe kam qenë përgjegjës i akivit të Lëvizjes. Kjo ishte ajo e mira tjetër në t’ keqë pra, kur nuk falej gjaku që ishte e keqja, po ishte e mira se jepnin fjalën se nuk do të marrim hak, ose në mënyrë tradicionale jepej besa. Siç jepet edhe sot dhe kto familje, domethanë dalin lirshëm pastaj kryejnë punët ditore edhe në treg, punët ditore në fushë dhe domethanë janë nën besë. Pra nuk kemi pasur rast dhe kjo ishte prapë ajo medalja tjetër e Lëvizjes që nuk ishte plotësisht e suksesshme, por megjithatë kishte sukses, pse kishte sukses domethanë nuk do t’ ndodhin vrasjet.

Erëmirë Krasniqi: Ju përmendët që Instituti Albanologjik ka qenë shtyllë kryesore e... që ka mbështet Aksionin e Pajtitimit të Gjaqeve. A kishte mujt me fol për rolin e Institutit pak ma detajisht?

Zymer Neziri: Po meqenëse profesori Anton vinte nga ky Institut, po vinte edhe Zeqa pra Zekerija Cana, po vinte edhe Muhamet Pirraku, tash i ndjerë edhe ai. Po e përmendi këtë treshe se nuk jetojnë, po vinin edhe të tjerë dhe sigurisht ky Institut kishte edhe një emër tjetër, një emër tjetër. Në atë kuptimin kishte edhe një za të madh për përpjekjet e mëdha që po i bënë, sepse vërtetë ky Institut përveç kësaj Lëvizjes së Pajtitimit dhe veprimeve të tjera, ky Institut bie fjala botoi 88 herë në periudhën e viteve ‘90. Kur ne punonim pa t’ardhuna dhe ne punonim në kushte të okupimit pra, dhe punonim edhe jashtë këtij Insitituti pra në një shpi private në Kodër të Diellit, dhe ky është një rast rekord i asaj që quhet botë intelektuale, kërkimore-shkencore t’ botoj 88 herë. Edhe qoftë në rrafshin krahasues me Akademinë e Shkencave në Tiranë dhe me tjetrën në Prishtinë ose me të gjitha fakultetet që i kishte Universiteti i Prishtinës. Domethanë ne ishim ata që ishin në terren çdo ditë sepse nëse s’ bonim asgja tjetër bile kërkonim. Duhej botuar “Gjurmimet Albanologjike” revista jonë pra, që është nisur në vitin 1971 në tri seri, dhe del edhe sot fatmirësisht. Numri 45 tash sa doli nga shtypi, dhe ne bënim punën, e bënim pa pagesë sepse s’kishte paga.

Po, kur vinte puna te shtypshkronja kishim noj lehtsim, por jo krejt pjesa që duhej paguar, ne dilnim, bize fjala në Therandë, dilnim në Pejë, në rrethinë, dilnim kudo qoftë. Kishim një mik, një shok, shkonim mledheshim pas darke dikush pesë marka, dikush dhjetë marka, dikush 15 i tubonim t’ hollat i jepnim shtypshkronjës dhe delte libri dhe libra. Ne pastaj iu çonim n’ terren edhe për fmi, edhe për shkolla, edhe për arsimtarë. Me fjalë tjera Instituti kishte edhe një zë popullariteti edhe për këtë aspekt prandaj, prandaj edhe punëtorët ishin shumë të gatshëm të jenë në terren. Dhe kësisoj vërtetë t’ bahet edhe shtylla qendrore ku brenda kishte prapë shtyllën qendrore të Lëvizjes së Pajtitimit, pra profesorin Anton Çetta. Ky Institut kishte edhe meritën e veçantë sepse këtu u themelua, thash edhe arkivi i Lëvizjes, këtu u mbledhshin të dhënat, këtu u hartuan edhe librat e parë për Lëvizjen pra se si duhet

t'mbahen shënimet, dhe fatmirësisht një pjesë e madhe e atij dokumentacioni ruhet sot në arkivën e Institutit, pjesërisht ruhen në arkivin e profesorit Anton.

Prandaj ky Institut vërtetë shumëfish kishte peshë, jo vetëm në Lëvizjen e Pajtimit, por në Lëvizjen në përgjithësi, domethanë Lëvizjen Kombëtare, deri te lufta e fundit ku një pjesë e asaj që quhet domethanë barnatore e emergjencës ishte këtu e vendosur, natyrisht me dijen e dy njerzve apo tre njerzve, po edhe deri aty domethanë kishte edhe angazhime të drejtperdrejta edhe për luftën për nanat që duhej lindshin, për t'lindur angazhim për to. Bie fjala kolegu im Emin Kabashi është kujdesur me këtë resor me Florë Brovinën. Dhe ky institut vërtetë kto merita që nuk janë të jashtzakonshme po janë merita të zakonshme për ni institucion dhe njerzit e tij, vërtetë ishin të mdha dhe tash erdh paslufta të cilat i paguam shumë keq i paguam tepër keq me UNMIK-un dhe me tjerët që vepruan si UNMIK-u me ministrat tanë nga i pari deri te i parafundit, i parafundit domethanë zbatoi ligjin i cili ishte ishte ligji, ligji ma diskriminues i intelektualve në Kosovë ku paguhet puntori n'institut me 39 përqind. Qëllimi, ikni nëse kini ku shkoni dhe ju të tjerët nëse doni t'vini më s'keni ku vini.

Dhe pastaj embargoja me pranimin e brezit të ri të hulumtuesve dhe tash gjendja është natyrisht në Institut rreth ni e katërta janë më pak sesa në vitin '99. Por megjithatë, meritat janë vërtetë të mëdha për këtë pjesë të historisë të shqiptarve, se ky institucion vërtetë ka qenë madhor, ka qenë me detyra madhore para historisë dhe para albanologjisë. Prandaj edhe sot me të drejtë krenohet me rreth gjashtëqind botime që i ka pra, gjatë rrugimit të vet nga themelimi i '53. Dhe këndej duhet marrë parasysh edhe ndërpremen pra, edhe duke marrë parasysh edhe edhe ndalesat. Po sot ky Institut domethanë për kto merita në histori që i ka, që s'kanë qenë, s'kanë qenë domethanë të vogla, por kanë qenë një detyrim prapë po them ndaj historisë dhe albanologjisë, sot nuk respektohen. Nuk respektohen nga qeveria e Kosovës sot, nuk janë respektuar dje, nuk janë respektuar nga viti '99 e këndej, sepse ky Institut që konsiderohej qendra e dytë e albanologjisë evropiane, ky Institut jeton keq. Biblotekën që e patë pak ma parë {drejtohet intervistuesës} me librat e falur mbijeton qe 17 vjet. Nuk janë 17 herë, herë që ky Institut ka blerë libra, jo, nuk ka me çka i blen. S'ka me çka i blen se shteti thotë, "S'kom! Dhe punë e jotja osht' a blen ti libra, a s'blen".

Erëmirë Krasniqi: Qysh e kalut luftën dhe qysh e ka kalu Instituti nëse mundeni me na përshkru?

Zymer Neziri: Po herën e parë kur studentët dhe arsimtarët nga t'gjitha fakultetet i qitën jashtë dhe u okupua Univerziteti këso, këso kohe. Natyrisht dhe Institutit i thanë, "Dilni" dhe deri në Akademinë e Shkencave dhe dolën t'gjithë, po ky Institut tha, "Jo, nuk dalim". Na erdhën letra me vija t'kuqe si i thonë, ne i kthenim mrapa, jemi në ndertesën tonë, Instituti osht' i yni, me letra osht' i yni dhe ne do ta vazhdojmë punën këtu. Dhe mbijetuam, domethanë n'kohën kur i okupuan të gjitha institucionet në Kosovë, ne ishim këtu.

Erëmirë Krasniqi: Ju u kthyet në atë kohë...

Zymer Neziri: Jo, nuk u kthyet, ishim këtu nuk dolem hiç...

Erëmirë Krasniqi: Po mendoj, a u kthytë në punë këtu në Institut?

Zymer Neziri: Unë, jo. Unë u ktheva në kohën, në vitin '90. Mua më larguan nga banka dhe unë e kalova këtu, kalova kohën këtu bashkë me profesorin Anton '91, '92. Edhe ndërprehet Lëvizja e Pajtimit të Gjaqeve me 17 maj 1992, unë ende nuk kisha status, se frigoheshin mos po çohet kush lugat dhe e bon Jugosllavinë prapë bashkë, dhe tek në qershor të '92 ma kthyen statusin. Domethanë saktisht me datën, me datën 26 të gjashtit, '92, e pata statusin, ndonëse unë isha këtu, veproja edhe në Lëvizje. Dhe tash këso kohe Insitituti, Instituti qëndronte mirë shumë me organizimin brenda që e kishte dhe ajo që quhej domethanë, gjithshmëri që u ba brenda për brenda për t' rezistuar, domethanë të themi, "Jo".

Por, kur u afrua puna për t'keq që pritnim, domethanë çastin se do të na sulmojnë, atëherë ne nxorrëm rreth 17 thasë akrivin, pjesën ma të mirë që e kishim, librat ma të rrallë që i kishim dhe i nxorrëm natën, pas mesnate. Dhe pastaj i vendosëm nëpër disa pika në qytet, natyrisht i fotokopjuam në mënyrë që ajo që quhet yndyrë dorëshkrimeve në Institut, e bërthamës së tij, e arkivit të tij, t'jetë jashtë dhe këta e bamë me shumë sukses. Pastaj vendosëm të nxjerrim edhe librat, morëm një kamion të 15 tonëve, morëm thasë të blojës të mullirit edhe disa studentë nga kimia na ndihmuan dhe u lodhëm shumë, ishte Ramazan. Disa e mbanin Ramazanin dhe i ngarkuam rreth tre qind thasë. Erdh patrulla e policisë, "Ç'po bëni?" "Ngarkojmë libra." "T'kujna jonë?" "Të tonat." "Ku po i çoni?" "Po i hekim, po i çojmë në depo." "Mirë." Erdh patrulla tjetër, prapë t'njejtat pyetje, "Ndaluni!" Erdh tjetra, "Zbrazni kamionin!" Dhe kjo ishte pjesa ma e randë se ishim lodhë s'kishim ma fuqi. Libri, pesha e randë si gurë, dhe i zbrazëm rreth një qind thasë, shkuan ata.

Erdh koha e iftarit u nalem te kjo... si i thonë furra e bukës këtu në "Kodër të Dillit", furra e parë aty, dhe morëm bukë, morëm çka gjetëm, u ngimë mirë dhe pastaj dikur ma vonë i ngarkuam librat prapë. Patrulla nuk erdhi, pas mesnate i çumë në "Lagjen e Spitalit" në një familje atje, dhe i vendosëm (kollitet). Ata u çuan në syfyr disa, na ndihmun, na nalën me pi çaj (buzëqesh) dhe kështu. Pastaj nuk na, nuk na kanë pengu ma me libra. Dhe në fazën e parë ne vërtetë ishim shumë, shumë të përgaditur, edhe me menjanimin e dokumenteve, dorëshkrimeve, të librave të rrallë. Pra në fazën e parë kemi qenë shumë, shumë të sukseshëm, e pastaj çka ndodhi? Ndodhën tjera. Erdhi vendimi prapë me tri vija të kuqe, veç na zuri viti '94, ne këtu, e kalum '93 po.

Domethanë ky Institut atë periudhë të, të pushtimit të institucioneve kulturore, arsimore dhe shkencore në Kosovë pra deri në Akademinë e Shkencave, ky Institut mbijetoi falë asaj kambëngulsie që të mos dorëzohet ndërtesa e Institutit. Ata dikur e humbën durimin me ne, dhe natyrisht organizonin njësi paramilitare që vinin këtu shanin, por edhe me gurë i thenin xhamat e dritareve, dhe herë-herë pastaj ka pasur një hudhje të mollotovit pra, në katin e sipërm. Domethanë, ishim vazhdimisht në shenjstër ose të rrugaqve, huliganve, si ju thonë ndryshe, ose të policisë, por megjthatë ne vazhdonim. Por, çka ndodhi? Pak para se të pushtohet Instituti ata vendosën një pushko-mitrolez përballë Institutit, në katin e sipërm, gjysmë kat kështu {tregon me duar} të çerdhës së femive këtu përballë, dhe vazhdimisht nga aty na kontrollonin edhe me grykën, si i thanë të, të armës edhe njëherit me kamera. Dhe sigurisht kanë bërë çudi. "Ç'bëjnë kta këtu? Me një laps në dorë dhe tërë këtë rezistencë e bëjnë. Askushi në Kosovë nuk bënë rezistencë dhe këta rezistojnë".

Ne në mbramje ishim pesë deri në mëngjes, kujdestaronim pesë kujdestarë, ndërsa deri në mesnatë ishim rreth pesëdhjetë, domethanë këtu rrinim edhe n'këtë sallë edhe në sallat e tjera. Në mëngjes vazhdojshim prapë normalisht, policia natyrisht na vëzhgonte dhe ditën e 8 marsit, '94 e hetuam se puna ndryshoi. Unë isha kujdestar atë natë, kujdestar kryesor dhe në mëngjes nuk shkova për t'fjetur në banesë, por qëndrova këtu deri në tre. Dhe thamë ç'po ndodh? Po ndodh diçka. Domethanë e hetuam dhe në tre më thanë, "Shko flej pusho pak". Tha, "Nëse ndodhë diçka na të therrasim me telefon edhe t'thomë ata erdhën". Dhe unë shkova në banesë, hoqa vetëm pallton dhe ashtu siç isha rashë dhe e zuna pak, si thonë (buzëqesh) pak gjum. Por nuk zgjati aq shumë, zgjati shumë pak, tepër pak sepse gruja më zgjoi edhe po thotë, "Po të thërrasin, ata erdhën". Ajo nuk e dinte çka domethanë, "Ata erdhën"(buzëqesh). E kom marr atë palltë në dorë e kom zanë autobusin e parë në lagjën "Qafa", kom ardhë këtu.

Po, erdha këtu veç i gjeta para dere rreth dhjetë të tjerë kishin ardhur, ata kishin hyrë mrenda, i kishin rrah punëtorët, këta t'shërbimit po, dhe kishim marrë një zinxhir të madh, të trashë dhe një dry të madh, dhe e kishin vendosur aty dhe e kishin mbyllur Institutin. Dhe pastaj ç'bëmë ne? E thyem drynin (buzëqesh), hymë mrenda, blemë një dry tjetër, e mbyllëm na derën prapë vet me një tjetër. Domethanë, ky ishte veprimi tjetër. Këtu në sallën poshtë u thamë grave dhe disa burrave të moshuar, ndër ta edhe profesori Idriz Ajeti, që ka qenë drejtor i këtij Instituti, profesor ynë pra, ai u ba edhe rektor i Univerzitetit, edhe i thamë, "Profesor, shkoni". Po, i thamë edhe profesorit Anton edhe disa të tjerëve, "Shkoni", kishim me t'meta, që çalonin. Nji nga punëtorët shkencorë dhe nji tjetër nga administrata dhe, "Ju, shkoni". Thanë, "Jo, çka t'bahet me ju, le t'bahet edhe me neve". Edhe gratë edhe burrat, dhe nuk u largu askush. Ishim mbi 44-45, saktësisht m'duket kanë qenë 43 nëse nuk gaboju tash. Dhe në zyrën time ishim diku rreth 15 duke pirë kafe dhe duke biseduar dhe atje u ndi, nji britmë shumë e madhe poshtë në hymje.

Ata e kishin thyer tash derën për herën e dytë, derën që ne ia thyem, derën që e mbyllen ata, tash e kishin thyer ata mbylljen tonë (buzëqesh). Po, dhe u kanë sjellë, si me thanë, këtyre punëtorëve që i kanë takuar aty, ndër ta drejtori, thotë, "Unë jam drejtori." "Ti je?" "Po". Edhe drejtorit i bien, e përgjakin, ia thejtnofullën, ia thejtnë dhambët, hundën dhe e bajnë njeriun krejt të larë me gjak, ashtu edhe të tjerët. Pastaj u ngjten lartë këtu te biblioteka ku ishit ju {ju referohet intervistueses dhe personit në kamerë}, aty e banë rresht si i thonë, *szpaler*¹ në t'majtë dhe të djathtë dhe aty ti duhej kaluar, dhe natyrisht i ndëshkonin të gjithë ata që kalonin aty pari. Ne u mundonim, bie fjala, të mbrojmë një kolege tonën aty me nji koleg, dhe natyrisht i ranë asaj pak ma pak, ne pak ma shumë. Kështu deri te shkallët. Te shkallët aty gjeta profesorin Anton, në pushimorën e parë i kishte mbetur koka poshtë kështu, kambët këndeju {tregon me lëvizje} edhe e ngrita, atij kolegut i thomë, Eminit, "A p'e merr profesorin?" Thotë, "Po". Edhe u nis në drejtim të oborrit.

Në pushimorën tjetër poshtë takoj profesorin Idriz, "Profesor, a je mirë?" Tha (buzëqesh), "Po, po, ku o dera?" {shpjegon me dorë} Dera ish aty, ish afër. E atij i kishin ra në katin e tretë, ku jemi ne këtu, domethanë në zyrën e drejtorisë. Një prej asistentave, "*Nemojte profesora!*", domethanë, "Mos sillni

¹ Polonisht: *Szpaler*, gardh. Përndryshe, mënyrë ceremoniale e rreshtimit në dy rende ballë përballë njëra tjetrës.

profesorit”. Ata e kapin për flokve ia dredhin krytë kështu {shpjegon me duar}, e rrxojnë edhe atë. Edhe kjo ishte përgjakja e Institutit domethanë, me datën, datën domethanë, 9 mars, i binte 1994 kur dolëm te dera. Një prej kolegëve, Ragip kështu quhet pra, Ragip Mulaku, një prej punëtorëve ma t’tmirë në Degën e Gjuhësisë, sigurisht duke u mbrojtur, ata mendojnë se donë të kacafytet me ta, ia kapin duart ia dredhin {shpjegon me duar}, ia kthejnë mbrapa, e lshojnë poshtë, e qesin kambën edhe e ndëshkojnë shumë, shumë randë.

Prapë një kolege tjetër, Myzafere quhet, Myzafere Mustafa, thotë “E mytën Ragipin”. Sadri Fetiu drejtori, me hy mrena, ne ishim ende këtu domethanë nuk kishim dalë, dhe i thomë, “Nuk bon me dalë!” “Jo,” thotë, “du. Le t’më vrasin”. Ai ishte krejt n’gjak i larë dhe bashkë me Myzaferin dhe me, na tretë hijmë, por ata me Ragipin kryen punë. Nuk e lshunë pse himë na, por megjithatë e lëshuan. Kur u afrum te xhamat, te dera, na dhanë një përplasje shumë të madhe, sa për fat unë i ngrita të dy duart {shpjegon me gjeste} edhe e mbrojta këtë pjesë kështu. Dhe kështu dolëm prej atyhit të përgjakur, me dhëmb të thyer, me nofulla të thyera, me dur të thyera, me kambë, me trup të lënduar, dulëm jashtë. Ata e kishin mbyllë këtë hyrjen ktu te semafori lart te menza e studentëve dhe semafori tjetër poshtë nuk kishte qarkullim të veturave po as të njerzve.

Por kur dulem poshtë, sa u nisëm për shpi të shëndetit, te ndihma e parë, kur dulëm aty plot rruga njerëz, qarkullonin njerzit, o Zot thojsh ti o festë. Ne ishim natyrsht të përgjakur, vazhduam rrugën deri në shpinë e shëndetit ku kishte nevoj për ndihmë të parë gati secili dhe kështu domethanë. E kaluam ri-pushtimin e Institutit dhe nuk na lanë për t’u kthyer këtu ma. Pastaj me do marrëveshje që ish edhe lojë e Serbisë dhe të tjerëve sigurisht, na lshunë Institutin pak para se të fillojnë, pak para se të filloj lufta. Mirëpo edhe ajo nuk zgjati shumë, deri në atë kohë ne vepruam në “Kodër të Dillit”, kabineti im që ishte përgjegjës i degës me dymbëdhjetë punëtor, ka pasur dymbëdhjetë metra katrorë, aq të takon edhe në burg bie fjala nëse shkon. Por, aty punohej me tri ndrresa, prandaj thashë kemi pasur shumë rezultate, rezultate të jashtëzakonshme dhe kemi merituar të kemi një status pak ma të mirë sot (buzëqesh) në vitin 2016, sesa që e kemi.

Erëmirë Krasniqi: A flasim për luftën qysh keni kalu ju dhe familja juaj?

Zymer Neziri: Po familja ime, natyrisht familja e gjerë dhe e ngushta këtu në Prishtinë nuk kaloi mirë, për shkak se këso kohe, shumë familje dhe shumë njerëz që duhej të largoheshin nga Prishtina, sidomos na që i kishim punët ma keq se të tjerët. Së paku për biografinë që e kishim, por edhe një aktivitet në rrethana shumë të thella, si i thonë, të asaj që quhet lidhje me shtabe të brigadave, lidhje, lidhje me luftëtarët në front, duhej, duhej të ruheshe shumë. Bie fjala, mua më sugjeruan që të largohesh thashë, “Jo, nuk do të largohem, se unë do të jem shembull i keq për gjashtë qind familje në lagjën ‘Qafa’, nuk do të largohem”. Dhe merre me mend aso kohe vjen një fatkeqësi familjare, jo shumë e vogël, gruja e then krahun, po, duke u munduar t’pastroj bojlerin, i rrëshet kama edhe bjen poshtë edhe e zenë këtë pjesë {tregon me dorë}, dy copash. Dhe tash, ajo ishte krejt në gips {shpjegon me dorë} e mobilizuar. Fëmija të vegjël, njoni dhjetë vjeç djali, tjeri njëmbëdhjetë, vajza qaty dikun afër me ta, domethanë ishte një familje që nuk mund të përballej me Serbinë, po me durë thatë.

Po jepnim një shembull moral edhe një shembull kombëtar pra, që të mos largohemi. Dhe kjo zgjati aq sa zgjati. Dhe e dini filluan pastaj bombardimet e NATO-s, në kohën e bombardimeve, në natën e parë e kaluam në banesë. Po, pata thirrje nga Gjermania, nga Amerika, nga Zvicra nga viset e tjera. “Amon mos i merr fëminë në qafë, nëse shkon ti, bile këta le t’shpëtojnë se i merr n’qafë ata”. Mirë, dola anej rruge te një i anës sime atje, bamë natën e dytë edhe m’u mush mendja, dojmë me dalë prapë m’u kthye n’banesë. Edhe dalim, pesë sa ishim: unë, gruja, tre fëmijët. Kalum rrugën hymë, kur vijmë knej djali i madh thotë, “Babë, milicia janë te hymja jonë”. Mirë, u kthym hymë n’hymje tjetër, u ngjitëm në katin e parafundit m’duket, te një shok dhe nejtëm një kohë aty.

Pas dy ore, trive, dolëm. I thomë djalit, “Vazhdo ti knej, unë po shkoj anën tjetër”, kqyrim domethonë a jonë hymjet e lira apo ka policë. Edhe del djali thotë, “Jo,” thotë, “nuk ka”. Ata paskan pa hy policët mrenda, ngjitën nëpër kate edhe kanë marrë, kanë lype karrika për mu ulë, po, dhe domethanë s’ka pasë polic deri n’katin e dytë. Thotë djali, “S’ka”, dhe ne u ngjitëm. Kur u ngjitem, thotë gruja (buzëqesh), “Milicia jonë hi mrenda.” “Ku janë?” Thotë, “Kenë te dera.” “Çka lypën?” “Karrika.” Tha, “Iu kanë vyjt në strehimore”. Se s’kemi pas naj karrikë t’mirë kumedit çfare, tha, “Edhe shkun përpjetë”. Dhe na nuk e dishim ç’po ndodh, fare. Ata paskan pa ardh dy patrulla të policisë 24 orëshe domethanë, edhe të patrollojnë edhe të rujnë.

Njo, një hyrje edhe një tjetër në katin e gjashtë, po kanë ardh shkaku i katit të gjashtë, shkaku se, katin e gjashtë qenka vendosur një komandat i policisë, policisë të veprimeve të shpejta një që nuk e harroj emrin e tij natyrisht me mbiermin, Bajraktarević. Dhe tash shkaku i tij domethanë, t’rujnë këta poshtë edhe njëherit roje atij lartë atje. Dhe tash domethanë kanë vendosur një shtab, sepse si duket miqët e tyre në NATO pra i kanë lajmëruar për ditën e sulmeve dhe këta i kanë hequr disa komanda nga ajo pikë aty ku kanë sulmuar pra, në qendrën e komandimit në oborrin e Ministrisë së Brendshme tash. Dhe ai njeri domethanë, është vendosur aty para sulmeve të NATO-s, po, domethanë ata veç e kanë ditur e më vonë doli se një gjeneral fancez ka tradhtuar pra, dhe e ka lamëruar domethanë Jugosllavinë aso kohe domethanë të mbetur dhe u ka thanë që, u ka thanë që domethanë do t’ketë sulme mbi, mbi Serbinë.

Tash ishte problemi si t’dalim nga, nga, nga, nga ndërtesa. Dhe gruja ime me gruen e atij shokut që ishte i vetmi që na hapi derë ni kat më poshtë nën ne, sepse lartë nuk ngjitej kush, domethanë pa dijen e policisë, dhe ato dilnin njëra te furra, “Te Sahiti” kështu quhet dhe tjetra... pak bërlllog dhe u bamë aty një banesë e vogël me 30 e sa metra u bamë, u bamë domethanë dy familje. Plus e kishin një të smurë nga veshkat aty, një plak domethanë dhe ishte në një, një gjendje jo aq të mirë. Dhe kaloi edhe dita e katërt, dhe ditën e katërt, domethanë krejt qëllimi ishte me m’nxjerrë mu prej aty, jo familjen, por unë me dalë sepse i rrezikojsha t’gjithë.

Edhe ka qenë një polic i Bosnjës të cilit ia dhanë një banesë si shpërblim aty, domethanë një polic që sigurisht ka masakruar njerëz në Bosnje, dhe ai ishte një, një njeri që s’dinte ç’është policia, ai tamon si qeni kur të shihte vinte mas teje. Po, po, jo si një polic që t’kqyrë në një mënyrë profesionale dhe t’kqyr manej me shpinë t’përcjellë, po. Dhe ishte rrezik, bie fjala, ai të di se jam aty. Bie fjala, se ndonji tjetër

nga policët... kështu që thonë, “T’shohim, t’bajmë diçka dhe dolëm nga aty”. Dola unë në t’vërtetë dhe kjo grua e këtij shokut tim, mikut tash, po thom një njeri që i kam borxh, si thonë, tanë jetën dhe fëmit e mij, që pati guximin me m’ marrë mrena me familje. Ka qenë ni pikë t’cilën e fiksonim ne, domethanë nga pamja e dritareve dhe në qoftëse nuk nalesh aty, domethanë, nuk ka rrezik [në] qoftëse nalesh vazhdimisht duhet mu ndalë aty n’atë pikë.

Dhe ne i përcjellshim edhe gruen time edhe gruen e tij, se në qoftëse domethanë ka rrezik, e hetojshim rrezikun. Dhe unë morra sinjal, domethanë shejë që nuk, nuk jonë policët te dera, sepse krisi një pushkë. Ata lshuen pikën kalunë në mes, se n’mes t’oborrit ka qenë edhe një makinë e kështu e, e pa mbulume me një pushko-mitrolez që sillej aty. Prapa njësia tjetër, se ata e mbushën poshtë atje depotë, depon e armëve domethanë e banë atje poshtë ku i kishim ne domethanë garazhdë ku jonë tash. Dhe unë dola, kur dola asaj gati e lshunë kambët dhe thotë, “Kuku për mu,” thotë, “na qujnë tradhëtarë për jetë t’jetëve,” thotë, “me bo me t’zanë.” “Po, hiç mos ki gajle”, kalova aty nëpër tunel. Kalova rrugën, dola n’atë familjën ku ishim vendosur domethanë ma herët, quhet familje lberdemaj, i kom edhe nga ana ime atje nga Shtupeqi dhe mund t’merrni me mend në një largësi prej tetëdhjetë metrash vi ajrore. Domethanë mbi tetë orë, familja ime është zhvendosur nga kjo pikë, në pikën tjetër. Domethanë, që t’mos biem në sy. Shko te buka merre një fëmi, kthehu këndejej dej te skaji lsho fëminë, me dalë anej, hajde vet këndeje, del mas dreke me tjetrin, tjetrin domethanë t’mos biem n’sy.

Shkum atje, u vendosëm, na pritën mirë, hapsinë kishte mjaft dhe mirë kaluem vetëm dy-tri net dhe erdhën një bandë paramilitarësh e plaçkitën familjën që kishte punët mirë, na plaçkitën edhe neve çka kishim me dokumente, me tytën e automatikut këtu n’zverg {shpjegon me dorë}, bile une morra këtë djalin e vogël, u tuta i madh pak, i thashë, “Lema mu këtë t’voglin”, grusë, “Merre atë tjetrin”. Po... dhe kryen punë dhe mas një kohe thanë, “Hupni, delni, kini pesë minuta!” Dhe dolëm ne diku nja 17, se aty ishin tri familje tash u bamë, dolëm, na ndalën patrulla, “Ku po shkoni?” S’dishe ku me thanë ku po shkoj, tregum që na kanë qitë tha, “Në orë policore?” Shkuen ata, atëherë na vendosëm m’u kthye. Por, jo m’u kthye me na hetu ata, por m’u çkepë nëpër atë lagje aty “Tophane”, dhe me hy ka pak, ka pak si me hi me vjedh, edhe hymë u bomë bashkë dikur.

E kryem atë natë, e kryem edhe ni natë tjetër, po çka ndodhi erdhën të tjerët. Ata erdhën n’uniforma, n’uniforma ushtarake, kishte edhe paramilitarë me ta, edhe veprunë si këta t’parët, po thanë, masi kryen punë thanë, “I keni vetëm tre minuta! Nuk jemi ata t’pesë minutave”. Domethanë, ata e dinin se ka qenë dikush para tyre aty dhe dolëm përsëri, dhe përsëri na ndodhi e njejta prapë, na ndalën patrullat thanë, “Është orë policore ushtarake, nuk ka lëvizje”.

Erëmirë Krasniqi: A nuk ju drejtojshin ka trenat, a najkun?

Zymer Neziri: Po dëgjo, kjo patrulla menjëherë (buzëqesh), domethanë me dalje prej shpije, me dalje prej shpije... jo na s’ishim nisë te treni, ne vendosëm, ne vendosëm, vendosëm t’mbesim aty, por vendosëm që fëmitë edhe ato dy gratë t’shkojnë. Por natyrisht, kur patëm një rast ashtu kqyrëm doli se

makina bënë me ecë, po nuk bënë me ecë se goma ishte e shpërthyme, ai skishte një rezervë dhe kshtu domethanë u kriju kjo situata e re tash. Dhe pastaj përsëri kemi vepruar si herën e parë prapë kemi hy aty si t'gjallë, a si t'dekun dhe nuk kemi dhanë kurrfar shejash mas mesnate. Dhe kaluam aty prapë një natë.

Natën tjetër ndodhi diçka e papëlqyeshme aty, shkak u im pra, me ni tjetër që erdhi aty. Dhe filloi me lujt mendsh dhe paska pasë thanë, “Që shkak u Zymerit mu kanë me ma vra gruen, kanë me i vra fëminë, kanë me m'vra edhe mu”, se domethanë, “Zymeri s'ka nejtë mirë, ka ba sherr, i ka ba sherr Jugosllavisë,” dhe Jugosllavia me bo me hetue që unë jom këtu, “na vret edhe neve”. Dhe mu gjumin e parë vjen gruja m'thërret thotë, “U tranue Filani”. Atëherë shkova fola me të thashë, “Unë pak i kom bo Jugosllavisë çka e ka lypë, po s'kom mujtë me i ba ma shumë, pra ba i kom, po sa kam mrrri me i ba, pra ti paç shëndetin, edhe gruja, edhe fëmija edhe keni me shpëtu me siguri sepse unë s'ju rrezikoj”. Edhe i kom thanë grues, “Si t'dahet pak agu, si t'del, unë t'përcjelli domethanë prej tavanit naltë, ke me dalë ke me marrë djalin me veti, t'madhin po, edhe ke mu nisë drejt furrës të bukës”. Domethanë, i binte diku ora pesë mëngjes edhe, “Në qoftëse nuk nalesh te stopi, unë e di që rruga është e çelun”, edhe unë po dalë me këtë djalin ma t'voglin, ai dhjetë vjeç, thashë edhe, “po dalim prej ktuhit”.

E kisha një lidhje në “Qafë” me hy në një familje që vinte nga Vushtrria dhe që kishin ni, ni njeri prapë të pa lëvizshëm n'familje, vetëm ata kishin mbetur në “Qafë” në këtë, në ndërtesën e tretë dhe grueja takohej me gruen që ishte, ishe motra e grues t'ni shokut tim dhe ka thanë nëse u vjen puna ngushtë dine që te na e keni ni strehë. Edhe unë u nisa aty. Dola, gruja nuk dha shejë qe o policia, dola me këtë t'voglin si i kemi afruar kësaj ndërtesës A, t'parës, domethanë bamë rrugë krejt nja 50 metra, e u nisëm n'drejtim të B-së, “Babë,” më thotë, “milicia,” djali... andej ka shkoi gruja, ka u nisë me shku te buka një truq polic nja gjashtë-shtatë, thashë, “S'kanë punë me ne”. Vazhdum, atyne nuk ua ka marrë mendja që n'atë kohë jem dalë, edhe u afrumë, himë te ajo ndërtesë, te C-ja. Në atë banesë na pritën mirë, tash gruja kur u shku herën e dytë e ka çu fminë tjetër, tjetër, tjetër. Prapë ni ditë rrugë kemi ba, domethanë m'u ba bashkë në dyqind metra rrugë.

Po... dhe u bamë bashkë n'mramje, n'mramje, n'mramje... sa u shtrua sofa troket dera edhe bukur si shumë, del ky i zoti i shpisë edhe unë e pashë atje n'derë ni kapelë policore ose ushtarake kështu {shpjegon me dorë}, e pashë, domethanë njeri i unifo... uniformum, domethanë vetëm kapelën e pashë, po ma shumë manej nuk pashë, se ata gjatë bisedës sigurisht që është largu nga ai kandi ku unë mund ta shihja. Ai paska qenë një boshnjak i cili paska punuar aso kohe në doganë, doganier, i thotë, “Kojshi,” thotë, “i keni punët keq,” thotë, “edhe na boshnjakët” thotë, “s'i kemi aq mirë,” thotë, “por, i keni punët shumë keq, vetëm një përparësi e keni se grupi i cili ka plaçkitë dhe ka dhunuar në drejtim të stadiumit dhe kësaj pjese të stacionit,” thotë, “ai grup nuk osht' ma, e kanë menjanu vetë policia, tjetër gja,” thotë, “s'keni ma shumë.” Thotë, “Këtu s'keni të nejtun!” Edhe u detyrum në mëngjes me dal prej atyhit domethanë nga lagjja “Qafa”, natyrisht me dhim të shumë të madhe dhe jemi nisë në drejtim t'stacion të trenit. Dy-tri patrulla policore i kemi taku nuk na nali kush. Në stacion

të trenit njeri i gjallë hiç, dhe me ardhjen e trenit sigurisht nuk e di sa mund të ketë 30-40 minuta jo ma shumë, si prej toke u dukë se po bijnë njerëz.

Erëmirë Krasniqi: Cila ditë e bombardimeve ishte?

Zymer Imeri: Kjo ka qenë data, data 3, 3 prill po. Dhe na kemi hyp normalisht në kupe, po jo normalisht kanë hyp të tjerët dhe u kam ndihmuar që të hypim dhe jemi ba në kupe diku mbi 20 e sa vetë domethanë në një si furrik, po. E kështu ishte ky rrugëtim, domethanë një prej rrugëtimeve ma të vështira në jetën time, jo për veti pra, po them, po për shkak të grus që thashë ishte veshun krejt njanin, {tregon me dorë} këtë rend domethanë me gips, fmitë e vegjël, domethanë të moshës shumë të vogël dhe natyrisht dhimbja tjetër ishte edhe për Prishtinën edhe për Kosovën. Dhe kështu rrugëtim kalum Fushën [Kosovën], kalum Ferizajin, kalum Kaçanikun deri në Bllacë. Bllacën e kalova pesë ditë e netë gati kom ba aty dhe ishte mjerimi ma i madh, domethanë i asaj që quhet prapë Evropë, me policinë e Maqedonisë sidmos me ata, me vdekjet e njerzëve pra, kanë vdekur me dhjeta, dhjeta njerëz. Aty janë mbi njëqind e sa vorre që u banë, ka pas edhe lindje, çka nuk ka pasë?! Ka qenë tmerr, ka qenë ferr.

Dhe prej atyhit manej thanë, “Jo, ka ra, ka ra kolera. Edhe po i lëshojmë të gjithë”, se nuk lëshojshin, nuk lëshojshin dhe kemi udhëtu tanë natën deri në Korçë, në stadium të Korçës. Aty autobusët janë kthyer prapa. Në kushte shumë të rënda në autobusa, ka qenë edhe aty prapë mu lëshue në tregime e drama. Muni me marr me mend njerëzit nuk kan mujt me kry nevojën dhe u dasht me marrë shishe, dhe në shishe kryhet nevoja, me gjujt jashtë, po e tjera e tjera. Domethanë, ke pas një status ma zi se me kanë i burgosun. Dhe rrugëtimi ka qenë shumë i gjatë, nuk e di ka i kanë ra, sigurisht kanë shku anej ka Ohri po m’duket, dhe Korçë.

Pastaj duhej m’u afërue te mjeku, për punë të grues shkum aty. “Jo, duhet me i nxjerr letrat administrata”, deri na i bani gati letrat për me shku ose në Tiranë ose në Durrës, por nuk kish banesa në Tiranë e në Durrës. E gjetem një banesë të cilën e pagum si në kohën e pushimeve verore (buzëqesh), po bile futbollist ishe ai tipi [pronari i shtëpisë] që jetonte në Itali, njëfarë familja Qendro. Por na nuk kishim të holla, mirëpo mundësitë për me pasë i kishim, se e kisha vëllaun në Gjermani, i kisha nipat në Zvicër e në Amerikë e domethanë mundësitë për me pasë ishin.

Se na pak patëm, edhe qato çka i patëm na i murrën natën e parë në atë bastisjën e parë, dhe natyrisht pastaj në spitalin e Durrësit atje ishte një trajtim i mirë. Unë vazhdova në Tiranë kom shku ma shpesh në Institut, kom taku këta djemtë e luftës që lëvizëshin, kom mbajt lidhje me ta. Pastaj dulën këta të brigadës tonë 136 Rugova dhe e sollën spitalin ushtarak aty, me ndihmën, prapë të tij, Gjeneralit që thashë të Kudosit. Dhe kjo ishte ajo pjesa që natyrisht dhemb, por pjesa ma e dhimbshme ishte se Prishtina nuk pat organizim për vetëmbrojtje, Prishtina nuk kishte. Ata djemtë e njësitit BIA, që quhej njësiti ishte shumë pak dhe nuk kanë pasur me çka, dhe kjo pjesë nuk është planifikuar fare se duhet të zbrazet Prishtina. Dhe ishte ajo pjesa shumë e dhimbshme, shumë e dhimbshme, por lufta ashtu si

ishite tash mund t'i qiten bishta, "Ka mujt kështu, kështu ajo... ", është e përfundime domethanë si proces historik, është i mbyllun. Por kjo nuk do të thotë se u mbyll problemi i shqiptarëve me serbët.

Erëmirë Krasniqi: Kur u kthyt prej Shqipnisë?

Zymer Neziri: Po u kthyem... po, përfundun bombardimet, unë isha në një ekspeditë që e organizuan me të ikurit nga Kosova nga Akademia e Shkencave dhe Institutet, isha disa ditë në ekspeditë me ta dhe u kthym këtu natyrisht në atë kohën e kthimit. E dini në çfarë gjendje ishte edhe në këto familjet tona jashtë Prishtinës? Familja ime kishte dy të vrrarë. Në rrethin e gjërë të familjes kështu kusheri, si i thonë, ishin poashtu edhe katër të masakruar. Njëri nga ta ka qenë i burgosur politik dhe i dënuar me vdekje pas Luftës së Dytë Botërore, ka mbajtur burgun, ka dalë, dhe e kanë marrë. Djali i madh thotë, "Mos ma merrni babën", ai diku rreth shtatëdhjetë vjeç. Thotë, "Jo, baba po flet shumë." E vërtetë baba ka fol shumë, se ishte i shurdhër, se nga rrahjet e mëdha nga burgu domethanë e kanë shurdhuar, nuk dinte tonalitetin si ta kordinoj me të tjerët kur fliste. "Po, po flet shumë plaku, hajde edhe ti", çohet djali i dytë. "Lemni babën edhe vëllaun se janë të moçëm, qe po vij unë", omethanë, në pushkatim. "Ani hajde, po na nuk po i lëshojna". Çohet ky tjetri që ka qenë moshatarë i imi, Shaqir e ka pas emrin, edhe thotë, "M'i lëshoni, qe po vij une". Edhe i thojnë, "Hajde edhe ti". Edhe e marrin domethanë edhe babën me tre djem i masakrojnë aty në hyrje të Zahaqit në një shpi, me sy me... e pastaj edhe i djejin kështu qe kur i kemi varros domethanë u dasht vetë t'i bësh domethanë katër kufoma.

E kjo ishte ajo pjesa që e kanë përjetuar shumë familje shqiptare në luftën e fundit, është një luftë që ka përfunduar, por një luftë që si konflikt me Serbinë shumë shekullor me ta, e pastaj shumë lufta, shumë beteja. Nuk ka përfunduar sepse Serbia nuk po donë me u nal dhe nuk po din edhe nuk e ka as vullnetin më të vogël me thanë, "Kom bo keq shumë, po nalna", qysh ka ditë me thanë një Gjermani pas Hitlerit, po e zamë.